

**RELACION MBI PROJEKT
BUXHETIN E BASHKISË
KORÇË TË VITIT 2024 DHE
PBA 2024-2026**

Dhjetor 2023



BASHKIA KORÇË

Përmbajtja e projekt buxhetit vjetor 2024 dhe PBA 2024-2026

1.	Hyrje	4
2.	Kuadri ligjor	6
3.	Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore	6
4.	Buxheti vendor 2024	7
5.	Buxhetimi gjinor	8
6.	Buxheti 2024	8
7.	Të ardhurat e veta të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	9
7.1.	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	10
7.2.	Të ardhurat nga institucionet e vartësisë	35
7.3.	Transferta e pakushtëzuar	36
7.4.	Transfertat e pakushtëzuara sektoriale	37
7.5.	Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore	39
8.	Buxheti i Bashkisë Korçë sipas dokumentave bazë dhe shoqërues	40
8.1.	Dokumentacioni bazë:	40
8.2.	Dokumentacioni shoqërues	47
9.	BUXHETI I BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2024, 2025 DHE 2026	54
9.1.	Programi: Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi AA122	55
9.2.	Programi: Siguria publike AB 122	57
9.3.	Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik AC122	59
9.4.	Programi AJ122 Fondi rezervë 04910	70
9.5.	Programi AK122 Fondi i kontigjencës 04940	70
9.6.	Programi Mbrojtja e Mjedisit AD122	71
9.7.	Programi: Shërbime Publike Vendore AE122	73
9.8.	Programi: Arsimiti Bazë dhe Parashkollor AG122	75
9.9.	Programi: Arsimiti i Mesëm i Përgjithshëm AH122	76
9.10.	Programi: Përkujdesi social AI122	78
10.	BUXHETI PËR INSTITUCIONET E VARËSISË PËR VITET 2024, 2025 DHE 2026	92
10.1.	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	92
10.2.	Klubi Shumësportësh	95
10.3.	Qendra e Artit dhe Kulturës	97
10.4.	Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes	101



BASHKIA KORÇË

10.5.	Qendra Ditore dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	115
10.6.	Shtëpia e Foshnjës	116



BASHKIA KORÇË

1. Hyrje

Hartimi i buxhetit ka rëndësi të madhe pasi është një mjet që i shërben nevojave të komunitetit bazuar në qasjen tonë vizionare për zhvillimin e qëndrueshëm. Në programin tonë të këtij mandati katër vjeçar që sapo ka filluar, ne kemi hartuar programe e projekte të rëndësishme për ta kthyer Korçën në një lokalitet me mirëqënie ekonomike e sociale të shtuar, në një hapësirë mundësish për të rinjtë, në një shtëpi të ngrohtë për të moshuarit, me punë e sipërmarrje të larmishme, me rritje të qëndrueshme në qytet e në fshatra, një hub idesh kreative dhe inovacioni.

Modernizimi i vullshëm infrastrukturor dhe projektet e mëdha strategjike të cilat do të zbatohet do të hapin perspektiva të reja për Korçën dhe banorët e saj.

Korça do të jetë më e madhe, me jetë vibrante dhe energji rinore, e para në art, kulturë e sport, një lokalitet që vrapon pa u ndalur drejt së ardhmes.

Edhe ky buxhet që prezantohet është në funksion të Korçës dhe qasjes sonë vizionare për zhvillimin e saj.

Investimet dhe projektet që parashikohen të financohen nga ky buxhet synojnë para së gjithash shtimin e mundësive për çdo banor në qytet dhe fshat, me potencial për rritjen e mirëqënies për çdo familje korçare.

Politikat tona fokusohen në katër drejtime të rëndësishme vizionare për zhvillimin e mëtejshëm të Korçës: turizmi, bujqësia, teknologjia dhe edukimi.

Vazhdimi i punës sonë drejt zhvillimit të qëndrueshëm në këto katër drejtime synon para së gjithash rritjen e mirëqënies për çdo familje nëpërmjet rritjes të të ardhurave dhe uljes së kostos së jetesës, mbrojtjen dhe krijimin e vendeve të punës, mbështetjen e bizneseve të reja dhe në rritje, mbështetjen e fermerëve me programe e projekte të rëndësishme në ndihmë të tyre dhe edukimin si rrugë e domosdoshme për rritjen e kapacitetetve dhe shtimin e mundësive për punësim.

Programet dhe projektet tona synojnë kthimin e Korçës në një qendër të rëndësishme dhe faktor zhvillimi për gjithë rajonin, me një ekonomi të fortë dhe të larmishme dhe një frymë sipërmarrëse prej të cilës përfitojnë të gjithë; një rajon i cili është në avantazhin e inovacionit dhe kërkimit dhe promovon dhe shfrytëzon trashëgiminë e tij të pasur natyrore dhe kulturore.

Në do të punojmë për një Korçë më të madhe, me zona të dedikuara e të zhvilluara me programe specifike për banim, industri, argëtim dhe turizëm.

Për një Korçë që kënaq shqisat dhe kujdeset për ndërtesat dhe rrugët e saj, duke ruajtur më të mirën e arkitekturës tradicionale e duke sjellë vlera të reja në aspektin e zhvillimit urban.



BASHKIA KORÇË

Për Korçën kryeqendër të turizmit gjithëvjetor dhe për shtimin e ofertës sonë turistike, shtimin e numrit të vizitorëve vendas e të huaj, duke e çmuar turizmin si një nga drejtimet më të rëndësishme potenciale të ekonomisë sonë lokale.

Për Korçën me bujqësi të zhvilluar, që mbështet fermerët dhe krijon modele që nxisin prodhimin bujqësor cilësor duke shtuar kështu mundësinë për shitjen e produkteve bujqësore e blegtorale.

Ne do të vazhdojmë të punojmë për mundësi në rritje për edukimin, sigurinë dhe argëtimin e fëmijëve, aftësimin profesional dhe punësimin e të rinjve nëpërmjet programit tonë të nxitjes së kreativitetit dhe teknologjisë.

Për vëmendje e mbështetje më të madhe për të moshuarit dhe shtresat në nevojë.

Për Korçën që promovon stilin e shëndetshëm të të jetuarit nëpërmjet nxitjes së sporteve, shtimit, mirëmbajtjes dhe promovimit të siteve natyrore dhe mjedisit.

Do të vazhdojmë të punojmë për një qeverisje transparente dhe etike, në një bashki që iu shërben njëlloj banorëve të saj në qytet dhe fshatra.

Së bashku me përkushtim e dashuri që Korça të vazhdojë të jetë e para!

Kryetari i Bashkisë

SOTIRAQ FILO



BASHKIA KORÇË

2. Kuadri ligjor

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore;
- Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
- Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për “Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.
- Ligje dhe akte nënligjore të tjera.

3. Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
2. Funkcionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.
4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohej me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
5. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.



BASHKIA KORÇË

4. Buxheti vendor 2024

Decentralizimi fiskal dhe financiar ka ecur me ritme të qëndrueshme në Shqipëri gjatë dekadave të fundit. Megjithatë, përgjegjësitë në rritje të qeverisjes vendore sjellin nevojën e rritjes së peshës së të ardhurave dhe shpenzimeve vendore ndaj PBB-së dhe shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, në veçanti rritja e të ardhurave nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e veta dhe taksat e ndara.

Reforma në modernizimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor është një proces i iniciuar tashmë prej disa vitesh, e cila mori një dimension të ri zhvillimi pas reformës administrativo-territoriale. Miratimi i ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, është cilësuar si një nga hapat e rëndësishëm, që do të ndihmojë në mbarëvajtjen e kësaj reforme. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka ndërmarrë masa të rëndësishme për mbështetjen e reformave decentralizuese duke kontribuar drejtpërdrejt në autonominë financiare të qeverisjes vendore, nëpërmjet konsolidimit të kuadrit ligjor të menaxhimit financiar në nivel vendor dhe duke rritur ndjeshëm autonominë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Reforma në financat vendore është fokusuar edhe në reformimin e sistemit buxhetor vendor me synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për fondet publike vendore.

Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore janë:

- Rritja e cilësisë së menaxhimit financiar nëpërmjet implementimit me sukses nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të procedurave të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, harmonizimit dhe unifikimit të procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore nëpërmjet përmirësimit të performancës së realizimit të të ardhurave të veta vendore;
- Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale duke i dhënë mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të rritur efektshmërinë në ofrimin e shërbimeve;
- Zbatimi i metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe zbatimi i buxhetit në nivel produkti;
- Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në Programin Buxhetor Afatmesëm duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- Ulja e numrit të programeve buxhetore (nga 36 programe në 20 programe buxhetore) dhe fillimi i një faze të re pilotimi për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetit Vjetor në nëntë bashki.
- Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;



BASHKIA KORÇË

- Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor: “Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.

5. Buxheti gjinor

Të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore. Të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore; Barazia gjinore, që i referohet gjendjes së burrave dhe grave që kanë mundësi dhe akses të barabartë në të njëjtat të drejta dhe përfitime.

Në buxhetin e vitit 2024 janë planifikuar projekte të cilat përfshijnë:

- marrjen në konsideratë të nevojave të ndryshme të grave dhe burrave.
- aktivitete me fokus gratë, fëmijët dhe të moshuarit

6. Buxheti 2024

Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2024 do të jetë **2,253,269 mijë lekë**, i planifikuar sipas 11 programeve, të cilat përfshijnë 27 funksione që menaxhohen nga Bashkia dhe Institucionet e Varësisë. Bashkia Korçë është përfshirë në një fazë të re pilotimi duke zbatuar metodologjinë për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetit Vjetor në nivel produkti, proces i cili ka filluar që nga viti 2023. Programet e reja buxhetore sipas metodologjisë së re do të shërbejnë si instrument i menaxhimit në Bashki.

Shpenzime për personelin	935,196 mijë lekë
Shpenzime korrente	1,009,364 mijë lekë
Shpenzime për investime	269,609 mijë lekë
Interesi dhe principali	39,100 mijë lekë
Total	2,253,269 mijë lekë

Shpenzimet për personelin ku përfshihet pagesa për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën 935,196 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 41.5%.

Shpenzimet korrente ku përfshihet pagesa për shpenzime operative, mirëmbajtje, shërbimi i pastrimit, shërbimi urban, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe e dëshmorëve, aktivitetet turistike,



BASHKIA KORÇË

kulturore, materiaile ndërtimi, transferta tek organizatat dhe transfertat tek individët, etj., për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën 1,009,364 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 44.8%.

Shpenzimet për investime ku përfshihet investime në infrastrukturën rrugore, shkolla, paisje të ndryshme, investime në pyje dhe kullota, etj., për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën 269,609 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 12%.

Shpenzimet për principalin dhe interesin e kredisë për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën 39,100 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 1.7%.

Detajimi dhe krahasimi i shpenzimeve do të jepet përgjatë materialit. Gjithashtu detajimi i buxhetit sipas sipas burimeve të financimit, llogarive ekonomike, institucioneve dhe produkteve do të jepen përgjatë materialit.

BUXHETI SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT:

Tabela 1: Burimet e financimit (vlerat në 000/lekë)

Burimet	Buxheti 2022 fillestar	Buxheti 2023 fillestar	Buxheti 2023 I ndryshuar	Buxheti 2024 sipas PBA 2024-2026 e rishikuar	Buxheti 2024	Dif PI 24-PBA 24-26 I rishikuar	%	Dif P24-PI23F	% PI24/PI23F
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore + të ardhurat e instat	1,060,304	1,192,786	1,192,786	1,204,663	1,246,212	41,549	103%	53,426	104%
Transferta e pakushtëzuar	462,077	532,062	532,062	560,733	598,629	37,896	107%	66,567	113%
Transfertat e pakushtëzuara sektoriale	334,248	348,482	363,352	351,967	378,550	26,583	108%	30,068	109%
Transferta e pakushtëzuar për rritjen e pagave			18,317		29,878	29,878		29,878	
Të tjera	32,696	4,150	5,950			-		(4,150)	0%
Total	1,889,325	2,077,480	2,112,467	2,117,363	2,253,269	135,906	106%	175,789	108%

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme buxheti i vitit 2024, krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2023, ka një rritje prej 175,789 mijë lekë ose 8.5% më shumë, sipas buxhetit të ndryshuar të vitit 2023, ka një rritje prej 140,802 mijë lekë ose 7% më shumë dhe krahasuar me buxhetin 2024 sipas PBA 2024-2026, i rishikuar, ka një rritje prej 135,906 mijë lekë ose afërsisht 6.4% më shumë.

Pesha specifike që këto burime zenë ndaj totalit të buxhetit janë si më poshtë:

Transferta e pakushtëzuar zë 27%

Transfertat e pakushtëzuara sektoriale zënë 18%

Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore dhe institucionet e varësisë zënë 55%

7. Të ardhurat e veta të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet që u vijnë



BASHKIA KORÇË

drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

7.1. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifat vendore dhe të ardhurat nga taksat e ndara.

Llogaritja e të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2024 është bazuar në :

1. Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr 153 date 07.12.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penaltitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2024";
2. Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
3. Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
4. Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar";
5. Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë";
6. Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
7. Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar;
8. Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
9. Ligji nr.10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
10. Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;
11. Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet", i ndryshuar;
12. Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", i ndryshuar;
13. Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
14. Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
15. Ligji nr. 89/2022 "Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake";
16. Ligji nr. 50/2023 " Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis";



BASHKIA KORÇË

17. VKM nr. 783, datë 10.11.2011, "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore";
18. VKM nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar;
19. VKM nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";
20. VKM nr.1108, date 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit";
21. VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", neni 27 pika 4;
22. VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës", i ndryshuar;
23. VKM nr. 475, datë 30.7.2021 "Për bashkëpunimin e njësiteve të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar";
24. VKM nr 207. Datë 15.03.2017 "Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth";
25. Udhëzim i Ministrit të Financave nr.1, datë 12.1.2007 "Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor";
26. Udhëzim i Ministrit të Financave nr.32, datë 31.12.2013, "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar;
27. Udhëzim i Ministrit të Financave nr.26, datë 4.09.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
28. Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore";
29. Udhëzuesi i Ministrit për Çeshtjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 "Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme";



BASHKIA KORÇË

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur:

- Në nivelet e aplikueshme të taksave dhe tarifave vendore të miratuara si në legjislacionin tatimor në fuqi ashtu dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkisë Korçë të cilat përcaktojnë llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajojnë çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcaktojnë qartë edhe administrimin e tyre duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.
- Në realizimet faktike të të ardhurave për periudhën paraardhëse dhe realizimin 11 muhor të vitit 2023.
- Në përlllogaritjet e kapaciteteve reale të taksave dhe tarifave nëpërmjet zgjerimit të bazës së taksapaguesve dhe saktësimin të të dhënave për të cilat janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, pronarë pasurish, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të taksave dhe tarifave sipas llojeve.
- Në parashikimin e mbledhjes së detyrimeve debitore, referuar legjislacionit në fuqi duke zbatuar me përpikmëri të gjitha hapat, procedurat dhe afatet e parashikuara si dhe duke bashkëpunuar ngushtë me aktorët e tjerë për vijimësinë dhe efektivitetin e këtyre masave.
- Në parashikimin e të ardhurave që mbledhen nga agjentët tatimorë duke kërkuar, rritur dhe forcuar më tepër kontrollin mbi ta por dhe mënyrën e rakordimit për taksat apo tarifatat që këta të fundit grumbullojnë për llogari të Bashkisë.
- Në parashikimin e të ardhurave që mbledhen nga drejtoritë dhe institucionet e Bashkisë.
- Në ecurinë e realizimit të të ardhurave për çdo taksë dhe tarifë si dhe duke analizuar faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.
- Në forcimin e kapaciteteve administruese.
- Në lehtësimin e procedurave dhe përmirësimin e klimës së marrëdhënieve me taksapaguesit.

Drejtoritë e Bashkisë, institucionet dhe agjentët tatimorë janë strukturat kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave nga burimet e veta vendore të Bashkisë Korçë.

Në mënyrë të detajuar po paraqesim realizimin e vitit 2021, realizimin e vitit 2022, planifikimin e vitit 2023, realizimin 11 muhor të vitit 2023, realizimin e pritshëm për vitin 2023 si dhe planifikimin për vitin 2024 në lidhje me të ardhurat nga burimet e veta vendore në Bashkinë e Korçës.



BASHKIA KORÇË

A	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	Realizim 2021	Realizim 2022	Plani 2023	Realiz.11muaj 2023	I pritshëm 2023	Plani 2024
1	TAKSË MBI NDËRTESEËN	114,846,019	122,707,067	197,673,192	109,895,303	122,523,742	207,129,048
2	TAKSË MBI TRUALLIN	12,601,210	12,042,427	23,414,724	11,964,428	12,236,504	24,672,790
3	TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE	20,386,785	20,387,837	65,886,435	17,990,441	23,281,476	57,863,459
4	TATIM FITIMI I THJESHTUAR PËR BIZNESIN E VOGËL	6,174,696	1,541,883	3,500,000	1,179,042	1,463,478	2,500,000
5	TAKSË PËR NDËRTIMET E REJA	134,234,446	104,224,382	222,000,000	107,053,820	110,000,000	280,000,000
6	TAKSË NDIKIMI NË INFRASTRUKURË NGA LEGALIZIMET	5,429,441	16,782,885	49,939,000	10,258,128	10,123,431	36,797,596
7	TAKSË FJETJE NË HOTEL	5,956,660	7,737,460	8,000,000	6,658,055	7,690,225	8,000,000
8	TAKSË TABELË	7,920,852	7,922,754	8,429,000	7,329,054	8,071,698	10,000,000
	TOTALI A	307,550,109	293,346,695	578,842,351	272,328,271	295,390,554	626,962,893
B	TË ARDHURA JO TATIMORE						
1	TARIFË PASTRIMI	160,894,253	160,014,535	225,945,805	145,988,186	162,072,072	202,767,653
2	TARIFË NDRIÇIMI	35,364,905	35,004,372	51,258,028	33,596,962	36,892,060	57,581,627
3	TARIFË GJELBËRIMI	23,731,605	23,210,914	32,143,581	21,188,899	23,159,363	38,216,328
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE	12,809,101	13,149,366	22,332,353	11,097,416	12,141,176	17,032,868
5	TARIFË ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE	20,993,471	21,243,712	27,265,930	19,607,994	21,157,072	27,699,000
6	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	1,105,340	976,365	1,300,000	1,010,655	1,077,905	1,300,000
7	TARIFË MUR PERIMETRAL	1,458,255	726,138	1,500,000	857,120	1,127,420	2,000,000
8	TARIFË PARKIMI	20,566,853	19,396,160	22,000,000	17,267,800	19,014,924	22,000,000
9	TE ARDHURA TE TJERA	10,880,337	15,035,510	7,400,000	12,617,411	13,346,348	6,755,040
10	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	523,250	325,000	350,000	446,000	498,000	425,000
11	MIRATIM PROJEKTI	595,000	850,000	500,000	1,075,000	1,255,000	1,500,000
12	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA	0	0	10,000	0	0	50,000
13	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETEVE	0	0	40,000	0	0	30,000
14	MARRJE ME QERA PYLLI+ QERA PER KULLOTA	3,816,355	8,712,064	8,990,000	6,759,670	8,879,317	8,031,200
15	TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT	1,600,000	2,346,060	3,000,000	0	0	100,000
16	VËRTETIME TRANSPORTI	66,000	48,000	60,000	29,400	35,400	70,000
17	PRODHIMET E DYTA MIDICINALE	0	0	1,000,000	0	0	1,000,000
18	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	688,000	311,000	1,000,000	173,000	198,000	1,400,000
19	GJOBA PËR VONESË NË PAGESË	6,857,732	5,258,446	6,000,000	5,219,591	6,201,731	6,000,000
20	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	2,041,716	2,581,858	2,500,000	2,410,804	3,032,804	2,500,000



BASHKIA KORÇË

21	GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	75,000	15,000	200,000	70,000	85,000	200,000
22	GJOBA TË D.T.T.V	120,000	20,000	200,000	120,000	200,000	200,000
23	QIRA OBJEKTI,QERA TRUALLI,QERA T.BUJQËSORE	8,860,957	8,549,473	9,500,000	9,599,439	9,921,717	9,017,585
24	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	555,000	520,000	500,000	595,000	615,000	1,375,000
25	TARIFE PËR LEJE NDËRTIMI	340,000	271,000	380,000	307,200	320,500	700,000
26	TARIFË SERVITUTI	618,740	680,870	1,500,000	681,234	751,258	1,339,255
27	TË ARDHURA NGA QIRATË, BANESA SOCIALE (CEB)	6,917,333	6,773,422	7,044,000	6,283,678	7,014,142	7,050,000
28	TË ARDHURA NGA BANESA SHTETËRORE	0	0	72,000	87,024	90,700	84,000
29	QIRA NGA BANESAT NË PRONËSI TË BASHKISË E.K.B	1,352,353	142,464	554,000	160,464	168,464	149,144
30	PRIVATIZIM BANESE	0	13,322,259	2,280,000	7,946,396	8,120,775	2,200,800
31	KAMATË VONESA(QIRA OBJEKTI)	230,043	492,276	500,000	279,247	388,906	300,000
32	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	0	1,871,100	2,800,000	2,940,812	3,732,595	6,750,000
33	TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SITEMIT KULLUES	9,930,685	9,001,182	36,567,952	7,175,960	9,044,452	28,907,078
	TOTALI B	332,992,284	350,848,546	476,693,649	315,592,360	350,542,099	454,731,578
C	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA						
1	TATIM SHITJEJE PASURI E PALUAJTSHME	22,932,304	20,402,161	25,000,000	5,902,199	7,194,580	25,000,000
2	TAKSË RREGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	43,262,884	44,057,543	47,000,000	41,760,551	46,397,568	55,000,000
3	RENTA MINERARE	331,454	549,188	700,000	440,756	461,865	700,000
4	TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE	22,090,739	24,932,778	35,000,000	23,499,042	31,499,042	45,000,000
	TOTALI C	88,617,381	89,941,670	107,700,000	71,602,548	85,553,055	125,700,000
	TOTALI A+B+C	729,159,774	734,136,911	1,163,236,000	659,523,179	731,485,708	1,207,394,471



BASHKIA KORÇË

TAKSAT VENDORE

Taksat vendore zenë 51.9 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen gjatë vitit 2024.

	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	Realizim 2021	Realizim 2022	Plani 2023	Realiz.11muaj 2023	I pritshëm 2023	Plani 2024
1	TAKSË MBI NDËRTESESËN	114,846,019	122,707,067	197,673,192	109,895,303	122,523,742	207,129,048
2	TAKSË MBI TRUALLIN	12,601,210	12,042,427	23,414,724	11,964,428	12,236,504	24,672,790
3	TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE	20,386,785	20,387,837	65,886,435	17,990,441	23,281,476	57,863,459
4	TATIM FITIMI I THJESHTUAR PËR BIZNESIN E VOGËL	6,174,696	1,541,883	3,500,000	1,179,042	1,463,478	2,500,000
5	TAKSË PËR NDËRTIMET E REJA	134,234,446	104,224,382	222,000,000	107,053,820	110,000,000	280,000,000
6	TAKSË NDIKIMI NË INFRASTRUKURË NGA LEGALIZIMET	5,429,441	16,782,885	49,939,000	10,258,128	10,123,431	36,797,596
7	TAKSË FJETJE NË HOTEL	5,956,660	7,737,460	8,000,000	6,658,055	7,690,225	8,000,000
8	TAKSË TABELË	7,920,852	7,922,754	8,429,000	7,329,054	8,071,698	10,000,000
	TOTALI	307,550,109	293,346,695	578,842,351	272,328,271	295,390,554	626,962,893

Taksat vendore me peshën më të madhe janë:

- **Taksa mbi ndërtesën zë 17.2% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 33% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**
- **Taksa mbi truallin zë 2% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 3.9% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**
- **Taksa mbi tokën bujqësore zë 4.8% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 9.2% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zë 23.2% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 44.7% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet zë 3% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 5.9% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**



BASHKIA KORÇË

Më konkretisht po i detajojmë më poshtë:

1. TAKSA MBI NDËRTESËN

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2024 planifikohet të jetë në vlerën **207,129,048 lekë** dhe zë **17.2 %** të planifikimit total për vitin 2024. Parashikimi për vitin 2024 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme dhe bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimit dhe vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve
- Verifikimit në terren si dhe vlerësimit në lidhje me vlerën e pronave
- Mbështetjes së agjentëve tatimorë
- Zgjerimi i numrit të taksapaguesve falë politikave lehtësuese, rivlerësimit të gjëndjes faktike, përmirësimit të marrëdhënieve dhe shërbimit me taksapaguesit si dhe bashkëpunimit me A.SH.K.

Bazuar në informacionin dhe regjistrat që ne disponojmë, planifikohen të përfshihen në skemën e detyrimit për këtë taksë **32,414 njësi pronësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 5,170,823.6 m²** në vlerën **156,911,636 lekë**, njësi pronësore këto që shfrytëzohen: për banim, nga subjektet e biznesit të vogël, nga subjektet e biznesit të madh, O.J.F apo njësi në pronësi të individëve të destinuar për prapimtarin social-ekonomike të cilët nuk i kanë vënë në shfrytëzim:

➤ Nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën **90,612,756 lekë** nga **27,522 njësi pronësore** që taksohen për banim me sipërfaqe **4,378,454 m²**, konkretisht:

- 18,269 njësi pronësore me sipërfaqe **3,241,965 m²** të destinuar për banim në vlerën **73,792,719 lekë** në njësinë administrative Korçë.
- 9,253 njësi pronësore me sipërfaqe **1,136,489 m²** të destinuar për banim në vlerën **16,820,037 lekë** në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë.

➤ Në njësinë administrative Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën **53,939,300 lekë**, për **4,405 njësi pronësore** për qëllime biznesi me sipërfaqe **610,601.16 m²** detajohet si më poshtë:

- 2,613 njësi pronësore me sipërfaqe **270,428.78 m²** të destinuar për tregëti dhe shërbime në vlerën **37,156,914 lekë**.
- 58 njësi pronësore me sipërfaqe **64,252.45 m²** të destinuar për prodhim në vlerën **2,942,762 lekë**.
- 1,446 njësi pronësore me sipërfaqe **260,963.69 m²** të destinuar për magazina si dhe objekte në të cilat nuk ushtrohet aktivitet në vlerën **11,952,138 lekë**.
- 288 njësi pronësore me sipërfaqe **14,956.24 m²** të destinuar për bodrume, garazhd dhe parking të mbuluar në pronësi të subjekteve të biznesit apo në pronësi të individëve me vlerë **1,887,486 lekë**.



BASHKIA KORÇË

➤ Në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën **12,359,580 lekë**, për 487 njësi pronësore për qëllime biznesi me sipërfaqe 181,768.02 m² detajohet si më poshtë:

- 398 njësi pronësore me sipërfaqe 104,339.41 m² të destinuara për tregëti dhe shërbime në vlerën **9,338,377 lekë**.
- 67 njësi pronësore me sipërfaqe 58,610.41 m² të destinuara për prodhim në vlerën **2,684,357 lekë**.
- 22 njësi pronësore me sipërfaqe 18,818.20 m² të destinuara për blegtori në vlerën **336,846 lekë**

Nga debitorët planifikohet të arkëtohet në vlerën **50,217,412 lekë** :

- Nga debitorët familjarë në njësinë administrative Korçë në vlerën **10,767,866 lekë**
- Nga debitorët familjarë në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë në vlerën **8,551,570 lekë**.
- Nga debitorët e subjekteve të biznesit apo individëve të cilët zotërojnë njësi pronësore të destinuara për aktivitet social-ekonomik si dhe nga njësitë pronësore në të cilat nuk ushtrohet aktivitet, në vlerën **30,897,976 lekë**.

Efkti ekonomik i përjashtimeve për taksën mbi ndërtesën.

Për vitin 2024 do të përjashtohen 6,114 familje me njësi pronësore për banim me sipërfaqe totale 509,427 m², konkretisht në njësinë administrative Korçë 4,971 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 417,987 m² në vlerën **9,613,701 lekë** dhe 1,143 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 91,440 m² në njësitë e tjera administrative me vlerë **1,371,600 lekë**.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor SH.R.U.K.KO. Sha.

2.TAKSA MBI TRUALLIN

Taksa mbi truallin për vitin 2024 planifikohet të jetë në vlerën **24,672,790 lekë** dhe zë **2%** të planifikimit total për vitin 2024 dhe **3.9%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore. Për vitin 2024 ky parashikim është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme dhe bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimit dhe vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve.
- Kategorizimit sipas qëllimit të përdorimit.
- Zgjerimi i numrit të taksapaguesve, rivlerësimit të gjëndjes faktike, përmirësimit të marrëdhënieve dhe shërbimit me taksapaguesit si dhe bashkëpunimit me A.SH.K.

Kjo taksë planifikohet të arkëtohet:



BASHKIA KORÇË

- Nga subjektet e biznesit në Bashkinë Korçë planifikohen të arkëtohen nga 752 njësi pronësore me sipërfaqe 1,091,943 m² në vlerën **13,156,673 lekë**.
- Nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohen të arkëtohen nga 18,178 njësi pronësore me sipërfaqe 7,592,325 m² në vlerën **3,188,777 lekë**.
- Nga debitorët e biznesit në vlerën **6,411,043 lekë**.
- Nga debitorët familjarë në vlerën **1,916,297 lekë**.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse janë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor SH.R.U.K.KO Sha.

3.TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2024 është planifikuar **57,863,459 lekë** me një sipërfaqe prej 12,534.12 ha (informacion i disponuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve) dhe zë **4.8 %** të planifikimit total për vitin 2024 dhe **9.2%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore. Parashikimi për vitin 2024 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme dhe bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimit dhe vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve
- Verifikimit në terren
- Zgjerimi i numrit të taksapaguesve, rivlerësimit të gjëndjes faktike, përmirësimit të marrëdhënieve dhe shërbimit me taksapaguesit si dhe bashkëpunimit me A.SH.K

Konkretisht të detajuara po i paraqesim në tabelat e mëposhtme:

Nr.	Njësia administrative	Sip / hektar	Vlera / lekë
1	Njësia administrative Korçë	393.12	796,167
2	Njësia administrative Bulgarec	3,604.00	6,937,900
3	Njësia administrative Drenovë	2,376.00	5,085,600
4	Njësia administrative Mollaj	2,292.00	4,603,500
5	Njësia administrative Vithkuq	1,792.00	4,121,600
6	Njësia administrative Voskop	1,272.00	2,002,200
7	Njësia administrative Voskopojë	488.00	683,200
8	Njësia administrative Lekas	317.00	443,800
	Totali	12,534.12	24,673,967



BASHKIA KORÇË

Kategoria e tokës (Boniteti)	Siperfaqja/ha	Çmimi në lekë/hektar/vit	Vlera / lekë
Kategoria III	12.00	2800	33,600
Kategoria IV	5,197.22	2300	11,989,685
Kategoria V	3,984.51	1900	7,570,563
Kategoria VI	2,012.80	1600	3,220,472
Kategoria VII-X	1,328.32	1400	1,859,646
TOTALI	12,534.12		24,673,967

Konkretisht për vitin 2024 planifikohen të arkëtohen:

- Nga 12,534.12 ha vlera e të cilëve përlloragitet në masën **24,673,967 lekë**, detyrim ky i vitit 2024
- Nga debitorët, vlera e të cilëve përlloragitet në masën **33,189,492 lekë**, debi kjo e përlloragitur për pronarët apo poseiduesit e tokës bujqësore të cilët nuk e kanë paguar këtë taksë për vitin 2023 dhe për periudhën paraardhëse.

4.TATIM I THJESHUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2024 parashikohet të jetë **2,500,000 lekë** parashikim ky i bërë nga të dhënat e mara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

5.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2024 planifikohet në vlerën **280,000,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zë **23.2%** të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe **44.7%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.

6.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2024 planifikohet në vlerën **36,797,596 lekë** parashikim ky i bërë nga të dhënat që Bashkia Korçë disponon, informacionet e shkëmbyera me A.SH.K duke marrë parasysh realizimin e kësaj takse për periudhën 2022-2023, numrin e legalizimeve të kryera si dhe debitorët për këtë taksë të cilët janë objekt i masave shtrënguese efekti i të cilave do të pasqyrohet gjatë vitit 2024.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet zë **3%** të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe **5.9%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.



BASHKIA KORÇË

7. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024 i taksës së fjetjes në hotel është bërë duke u bazuar në numrin e njësive që japin strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim si dhe kapacitet akomoduese të tyre. Kjo taksë për vitin 2024 planifikohet në vlerën **8,000,000 lekë** nga 136 subjekte (Bujtina / Hotele) të detajuara si më poshtë:

- 52 bujtina me kapacitet akomodues 771 persona
- 84 hotele me kapacitet akomodues 2732 persona

Gjithashtu pritet që gjatë vitit 2024 të hyjnë në funksionim 6 bujtina dhe 9 hotele të cilët aktualisht janë duke investuar në këtë fushë. Arkëtim gjatë vitit 2024 do të ketë dhe nga ato subjekte të cilat nuk do ta paguajnë këtë taksë brenda vitit 2023 për vetë faktin se taksën e fjetjes në hotel për muajin dhjetor subjektet e paguajnë brenda datës 5 Janar të vitit 2024, gjithashtu dhe nga ato subjekte që nuk kanë paguar brenda afatit të përcaktuar këstet mujore të vitit 2023 apo dhe debitorë të viteve të mëparëshme të cilat do të jenë objekt i masave shtrënguese konform legjislacionit në fuqi.

8. TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

-Tabela për qëllime identifikimi, mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.

-Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike dhe që përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.

-Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Taksa e tabelës për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **10,000,000 lekë**, parashikim ky nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit i cili bazohet në administrimin dhe pasurimin e të dhënave për numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim, numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese mbi 2 m² dhe sipërfaqen e tyre si dhe numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë reklamuese, sipërfaqen e tyre të ndodhura në Bashkinë Korçë dhe debitorët.



BASHKIA KORÇË

Nr	Taksa e Tabelës	Nr.subjekte	Sipërfaqja m ²	Vlefte/njësi	TOTAL
1	Tabelë e thjeshtë	42	223.8	22,500	5,035,815
2	Tabelë e thjeshtë (mbi 2 m ²)	18	86.8	10,000	867,760
3	Tabelë me ndriçim (mbi 2 m ²)	46	223.8	15,000	3,356,300
4	Tabele Elektronike	1	1.11	45,000	49,950
5	Debitorë	2	13.16	15,000	197,425
		8	21.9	22,500	492,750
		117	570.57		10,000,000

TARIFAT VENDORE

Tarifat vendore zenë 37.7 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen gjatë vitit 2024.

	TË ARDHURA JO TATIMORE	Realizim 2021	Realizim 2022	Plani 2023	Realiz.11muaj 2023	I pritshëm 2023	Plani 2024
1	TARIFË PASTRIMI	160,894,253	160,014,535	225,945,805	145,988,186	162,072,072	202,767,653
2	TARIFË NDRIÇIMI	35,364,905	35,004,372	51,258,028	33,596,962	36,892,060	57,581,627
3	TARIFË GJELBËRIMI	23,731,605	23,210,914	32,143,581	21,188,899	23,159,363	38,216,328
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE	12,809,101	13,149,366	22,332,353	11,097,416	12,141,176	17,032,868
5	TARIFË ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE	20,993,471	21,243,712	27,265,930	19,607,994	21,157,072	27,699,000
6	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	1,105,340	976,365	1,300,000	1,010,655	1,077,905	1,300,000
7	TARIFË MUR PERIMETRAL	1,458,255	726,138	1,500,000	857,120	1,127,420	2,000,000
8	TARIFË PARKIMI	20,566,853	19,396,160	22,000,000	17,267,800	19,014,924	22,000,000
9	TE ARDHURA TE TJERA	10,880,337	15,035,510	7,400,000	12,617,411	13,346,348	6,755,040
10	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	523,250	325,000	350,000	446,000	498,000	425,000
11	MIRATIM PROJEKTI	595,000	850,000	500,000	1,075,000	1,255,000	1,500,000
12	SHËRBIME	0	0	10,000	0	0	50,000



BASHKIA KORÇË

	ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA						
13	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETEVE	0	0	40,000	0	0	30,000
14	MARRJE ME QERA PYLLI+ QERA PER KULLOTA	3,816,355	8,712,064	8,990,000	6,759,670	8,879,317	8,031,200
15	TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT	1,600,000	2,346,060	3,000,000	0	0	100,000
16	VËRTETIME TRANSPORTI	66,000	48,000	60,000	29,400	35,400	70,000
17	PRODHIMET E DYTA MIDICINALE	0	0	1,000,000	0	0	1,000,000
18	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	688,000	311,000	1,000,000	173,000	198,000	1,400,000
19	GJOBA PËR VONESË NË PAGESË	6,857,732	5,258,446	6,000,000	5,219,591	6,201,731	6,000,000
20	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	2,041,716	2,581,858	2,500,000	2,410,804	3,032,804	2,500,000
21	GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	75,000	15,000	200,000	70,000	85,000	200,000
22	GJOBA TË D.T.T.V	120,000	20,000	200,000	120,000	200,000	200,000
23	QIRA OBJEKTI,QERA TRUALLI,QERA T.BUJQËSORE	8,860,957	8,549,473	9,500,000	9,599,439	9,921,717	9,017,585
24	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	555,000	520,000	500,000	595,000	615,000	1,375,000
25	TARIFE PËR LEJE NDËRTIMI	340,000	271,000	380,000	307,200	320,500	700,000
26	TARIFË SERVITUTI	618,740	680,870	1,500,000	681,234	751,258	1,339,255
27	TË ARDHURA NGA QIRATË, BANESA SOCIALE (CEB)	6,917,333	6,773,422	7,044,000	6,283,678	7,014,142	7,050,000
28	TË ARDHURA NGA BANESA SHTETËRORE	0	0	72,000	87,024	90,700	84,000
29	QIRA NGA BANESAT NË PRONËSI TË BASHKISË E.K.B + PRIVATIZIMI I BANESAVE	1,352,353	142,464	554,000	160,464	168,464	149,144
30	PRIVATIZIM BANESE	0	13,322,259	2,280,000	7,946,396	8,120,775	2,200,800
31	KAMATË VONESA (QIRA OBJEKTI)	230,043	492,276	500,000	279,247	388,906	300,000
32	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	0	1,871,100	2,800,000	2,940,812	3,732,595	6,750,000



BASHKIA KORÇË

33	TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SITEMIT KULLUES	9,930,685	9,001,182	36,567,952	7,175,960	9,044,452	28,907,078
	TOTALI	332,992,284	350,848,546	476,693,649	315,592,360	350,542,099	454,731,578

Tarifat me peshën më të madhe janë:

- **Tarifa e pastrimit zë 16.8% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 44.6% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifa e ndriçimit zë 4.8% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 12.7% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifa e gjelbërimit zë 3.2% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 8.4% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifë vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sitemit kullues zë 2.4% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 6.4% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifa për zënien e hapësirave publike zë 2.3% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 6.1% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**

Më konkretisht po i detajojmë më poshtë:

1.TARIFA E PASTRIMIT

Tarifa e pastrimit është planifikuar në vlerën **202,767,653** lekë dhe zë **16.8 %** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2024 dhe **44.6%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore. Parashikimi për vitin 2024 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme nëpërmjet:

- Përditësimit dhe përmirësimit të të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore
- Verifikimit në terren nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative për familjet efektive
- Verifikimit në terren nga inspektorët e D.T.T.V në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitet
- Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Q.K.B, D.R.T, SH.R.U.K.KO dhe Zyrën e Gjëndjes Civile në lidhje me nr e subjekteve dhe familjeve të regjistruara në Bashkinë Korçë

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

- 2,604 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **27,531,700** lekë
- 720 subjekte të biznesit të madh në vlerën **39,243,000** lekë
- 80 institucione shtetërore dhe ojf në vlerën **2,156,000** lekë
- subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit në vlerën **13,250,000** lekë
- 19,792 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **75,209,600** lekë



BASHKIA KORÇË

- 8,069 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën **12,007,500 lekë**
- debitorët familjarë në vlerën **17,266,521 lekë**
- debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën **16,103,332 lekë**.

Efekt i ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e pastrimit.

Për vitin 2024 efekti financiar nga përjashtimet apo lehtësitë fiskale përlllogaritet në vlerën prej **15,369,400 lekë**.

1. Subjekte të cilat përfitojnë 20% ulje të tarifës së pastrimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 61 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **662,800 lekë** :
 - 23 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 266,000 lekë
 - 26 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 356,000 lekë
 - 12 Institucione arsimore private dhe ojf në vlerën 40,800 lekë
2. Subjekte të cilat përfitojnë 50% ulje të tarifës së pastrimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 19 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **413,500 lekë** :
 - 6 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 160,000 lekë
 - 5 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 165,000 lekë
 - 2 organizata jofitimprurëse me aktivitet sportiv në vlerën 30,000 lekë
 - 6 subjekte dedikuar fëmijëve në vlerën 58,500 lekë
3. Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 36 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **1,175,000 lekë** :
 - Nga 20 subjekte të biznesit në vlerën 855,000 lekë
 - Nga 16 Ojf fetare në vlerën 320,000 lekë
4. Nga 3,945 familje që përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit si rezultat i lehtësive fiskale në vlerën **13,118,100 lekë**.



BASHKIA KORÇË

2.TARIFË NDRIÇIMI

Tarifa e ndriçimit planifikohet në vlerën **57,581,627 lekë** dhe zë **4.8%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2024 dhe **12.7%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.

Parashikimi për vitin 2024 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme nëpërmjet:

- Përditësimit dhe përmirësimit të të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore
- Verifikimit në terren nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative për familjet efektive
- Verifikimit në terren nga inspektorët e D.T.T.V në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitet
- Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Q.K.B, D.R.T, SH.R.U.K.KO dhe Zyrën e Gjendjes Civile në lidhje me nr e subjekteve dhe familjeve të regjistruara në Bashkinë Korçë

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

- 2,604 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **15,669,800 lekë**
- 720 subjekte të biznesit të madh në vlerën **8,136,100 lekë**
- 80 institucione shtetërore dhe ojf në vlerën **600,500 lekë**
- subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit në vlerën **750,000 lekë**
- 19,792 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **18,789,100 lekë**
- 8,069 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën **5,420,700 lekë**
- debitorët familjarë në vlerën **3,778,046 lekë**
- debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën **4,437,381 lekë**

Efkti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e ndriçimit.

Për vitin 2024 efekti financiar nga përjashtimet apo lehtësitë fiskale përlllogaritet në vlerën prej **3,144,000 lekë**.

1.Subjekte të cilat përfitojnë 20 % ulje të tarifës së ndriçimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 61 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **135,100 lekë** :

- 23 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 57,600 lekë
- 26 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 60,800 lekë
- 12 Institucione arsimore private dhe ojf në vlerën 16,700 lekë

2.Subjekte të cilat përfitojnë 50 % ulje të tarifës së ndriçimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 19 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **98,750 lekë** :



BASHKIA KORÇË

- 6 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 39,000 lekë
- 5 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 27,500 lekë
- 2 Ojf sportive në vlerën 7,500 lekë
- 6 subjekte dedikuar fëmijëve në vlerën 24,750 lekë

3.Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së ndriçimit referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 36 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **312,000 lekë**:

- 20 subjekte të biznesit në vlerën 192,000 lekë
- 16 Ojf fetare në vlerën 120,000 lekë

4.Nga 3945 familje që përjashtohen nga pagesa e tarifës së ndriçimit si rezultat i lehtësive fiskale në vlerën **2,598,150 lekë**.

3.TARIFË GJELBËRIMI

Tarifa e gjelbërimit planifikohet në vlerën **38,216,328 lekë** dhe zë **3.2%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2024 dhe **8.4%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifave vendore.

Parashikimi për vitin 2024 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme nëpërmjet:

- Përditësimit dhe përmirësimit të të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore
- Lehtësive fiskale të ndërmara nga Bashkia Korçë
- Verifikimit në terren nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative për familjet efektive
- Verifikimit në terren nga inspektorët e D.T.T.V në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitet.
- Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Q.K.B, D.R.T, SH.R.U.K.KO dhe Zyrën e Gjendjes Civile në lidhje me nr e subjekteve dhe familjeve të regjistruara në Bashkinë Korçë.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga :

- 2,270 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **12,611,600 lekë**
- 720 subjekte të biznesit të madh në vlerën **5,135,000 lekë**
- 80 institucione shtetërore dhe ofj në vlerën **521,100 lekë**
- subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit në vlerën **1,250,000 lekë**
- 19,792 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **13,854,400 lekë**
- debitorët familjarë të njësisë administrative Korçë në vlerën **1,629,293 lekë**
- debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën **3,214,935 lekë**



BASHKIA KORÇË

Efekt i ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e gjelbërimit.

Për vitin 2024 efekti financiar nga përjashtimet apo lehtësitë fiskale përlllogaritet në vlerën prej **1,955,550 lekë**.

Subjekte të cilat përfitojnë 20 % ulje të tarifës së gjelbërimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 51 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **89,300 lekë**:

- 23 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 35,400 lekë
- 26 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 39,600 lekë
- 12 Institucione arsimore private dhe ojf në vlerën 14,300 lekë

1. Subjekte të cilat përfitojnë 50 % ulje të tarifës së gjelbërimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 17 subjekte me një ndikim në Buxhetin e bashkisë me një vlerë prej **64,250 lekë**:

- 6 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 22,000 lekë
- 5 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 17,000 lekë
- 2 Ojf sportive në vlerën 6,500 lekë
- 6 subjekte dedikuar fëmijëve në vlerën 18,750 lekë

2. Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së gjelbërimit referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 36 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **236,000 lekë**:

- 20 subjekte të biznesit në vlerën 132,000 lekë
- 16 Ojf fetare në vlerën 104,000 lekë

3. Nga 3,236 familje që përjashtohen nga pagesa e tarifës së gjelbërimit si rezultat i lehtësive fiskale në vlerën **1,566,000 lekë**.

4.TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

Parashikimi për vitin 2024 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme nëpërmjet:

- Përditësimit dhe përmirësimit të të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore.
- Lehtësive fiskale të ndërmara nga Bashkia Korçë.
- Verifikimit në terren nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative për familjet efektive.
- Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me SH.R.U.K.KO dhe Zyrën e Gjëndjes Civile në lidhje me nr e familjeve të regjistruara në Bashkinë Korçë.

Tarifë mirëmbajtje varreza publike është planifikuar në vlerën **17,032,868 lekë** dhe zë **1.4%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2024 dhe **3.7%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifave vendore.



BASHKIA KORÇË

Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga:

- 19,792 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **9,896,000 lekë**,
- 8,060 familje rezidente efektive të njësisë administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën **4,010,500 lekë**
- debitorët familjarë parashikohet në vlerën **3,126,368 lekë**.

Efekti ekonomik i përjashtimeve për tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike.

Për vitin 2024 efekti financiar nga përjashtimet apo lehtësitë fiskale përlllogaritet në vlerën prej **1,786,000 lekë**

Nga 3,945 familje që përjashtohen nga pagesa e tarifës së mirëmbajtjes së varrezave publike si rezultat i lehtësive fiskale në vlerën **1,971,000 lekë**.

5.TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Tarifë për zënien e hapësirave publike për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **27,699,000 lekë**, bazuar në parashikimin e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për sipërfaqet dhe zënien e hapësirës publike të cilat përdoren dhe do të përdoren për qëllime të ndryshme siç janë zënia e hapësirave publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, etj, zënia e hapësirave publike për tregëtim në tregje publike të miratuara nga bashkia të artikujve ushqimore, fruta – perime, vezë, mish, peshk, bulmet, e.t.j, zënia e hapësirave publike për tregëtim tek inkubatori i biznesit (ish UMB) të artikujve industrial, zënia e hapësirave publike për organizim evente të ndryshme, panaiere, zënia e hapësirave publike për tregëtim të artikujve industriale të artikujve ushqimore, fruta – perime, kantina, kënde lojrash, zënia e hapësirave publike për tregëtim tek Tregu i gjësë së gjallë, e.t.j. Kjo tarifë zë **2.3%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2024 dhe **6.1%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.

Në lekë

Nr.	Tarifë zënie hapësirë publike	Vlera vjetore në / lekë
1	Me tavolina jashtë lokalit	14,838,378
2	Ekspozim malli	1,202,600
3	Aktivitet fast-food (Kantina)	396,000
4	Promocione	70,000
5	Tregu industrial (ish UMB)	3,452,000
6	Tregu ushqimor Markata e Shijes	3,780,000
7	Tregu i gjësë së gjallë	900,000
8	Debitorë	3,060,022
	Total	27,699,000



BASHKIA KORÇË

Efekti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e zënies së hapësirës publike.

Për vitin 2024 vlera prej **871,441 lekë** përlllogaritet si rezultat i përjashtimit nga tarifimi i subjekteve që shërbejnë me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike për muajt Janar-Shkurt dhe Dhjetor 2024.

6.TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Tarifë regjistrimi për lejë transporti për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **1,300,000 lekë** planifikim ky i bërë nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit me shkresën nr. 8008 datë 12.10.2023. Plani i të ardhurave të parashikuara, bazohet tek trendi i aplikimeve për rinovimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që pajisen me liçensën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë. Sipas kategorizimit ky parashikim do të realizohet si më poshtë :

1. Transporti i udhëtarëve me taksi planifikohet në vlerën 450,000 lekë
2. Transporti i mallrave planifikohet në vlerën 570,000 lekë (në këtë kategori pjesën kryesore e zënë automjetet e subjekteve të ndërtimit me tonazh të lartë. Sipas kërkesave të subjekteve këto automjete në pjesën më të madhe janë pajisur me çertifikata dhe autorizime me afat mbi 1-vjeçar).
3. Transporti i udhëtarëve planifikohet në vlerën 280,000 lekë.

7.TARIFË PËR MUR PERIMETRAL

Tarifë për mur perimetral për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **2,000,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

8.TARIFË PARKIMI

Tarifë parkimi për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **22,000,000 lekë**, planifikim ky i kryer nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit bazuar në :

- 93 subjekte të cilat kanë rezervuar 143 vende parkimi me interval të ndryshëm kohor në vlerën 5,500,000 lekë
- 317 vend parkime me pagesë në vlerën 14,981,340 lekë
- Tarifa e parkimit rezident parashikohet në vlerën 61,200 lekë
- në numrin e mjeteve që transportojnë mall për llogari të vet, për të tretë në vlerën 180,000 lekë
- 81 liçensa për mjete taksitaxi (1+4) parashikohet në vlerën 392,000 lekë
- Nga debitorët në vlerën 855,460 lekë.



BASHKIA KORÇË

9.TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata,etj) për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **6,775,040 lekë**, parashikim ky i bazuar në të dhënat e mara nga drejtoritë apo institucionet përkatëse.

10.ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Të ardhura nga çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **425,000 lekë**, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

11.MIRATIM PROJEKTI

Të ardhura nga miratim projekti për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **1,500,000 lekë**, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

12.SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA

Të ardhura nga shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **50,000 lekë**, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

13.SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TË TRETËVE

Të ardhura nga shërbime zjarrfikse ndaj të tretëve për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **30,000 lekë**, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

14.MARRJE ME QIRA PYLLI / KULLOTA

Marrje me qira pylli / kullota për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **8,031,200 lekë**, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë bazuar në kontratat e lidhura konkretisht për marrje me qira fond pyjor/kullor antenna, marrje me qira fond pyjor/kullor për HEC, marrje me qira fond pyjor/kullor nga subjekte të ndryshme e detajuar si më poshtë:

- Kontrata qiraje me qëllim pushim argëtim në vlerën 160,000 lekë
- Kontrata qiraje për akuakulturë në vlerën 38,200 lekë.
- Kontrata qiraje me kompanitë celulare në vlerën 1,000,000 lekë.
- Kontrata qiraje për mbjellje arrorësh në vlerën 633,000 lekë.
- Kontrata qiraje për kullotje në vlerën 1,200,000 lekë.
- Kontrata qiraje për ndërtim HEC në vlerën 5,000,000 lekë.



BASHKIA KORÇË

15.TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT DHE HEQJA E MATERIALIT DRUSOR

Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe heqja e materialit drusor për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **100,000 lekë**, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë.

16.VËRTETIME TRANSPORTI

Të ardhura nga vërtetime transporti për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **70,000 lekë**, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë.

17.TË ARDHURA NGA PRODHIMET E DYTA MEDICINALE

Të ardhura nga prodhimet e dyta medicinale për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **1,000,000 lekë**, si rezultat i shitjes së BMET si Dëllinjë e Kuqe dhe Dëllinjë e Zezë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë.

18.GJOBA POLICIA BASHKIAKE

Gjoba Policia Bashkiake për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **1,400,000 lekë** duke përfshirë dhe gjobat e pa mbledhura gjatë vitit ushtrimor korent apo atij të mëparshëm.

19.GJOBË PËR VONESË NË PAGESË

Gjobë për vonesë në pagesë për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **6,000,000 lekë**, parashikim ky i bazuar në detyrimet e papaguara të viteve të mëparshme, detyrimet e subjekteve të cilët nuk arritën që të kryenin pagesat brenda vitit ushtrimor për të cilat gjoba për vonesë në pagesë vazhdon të përlogaritet, si dhe në ecurinë e vitit aktual.

20.GJOBA TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **2,500,000 lekë** duke përfshirë këtu dhe gjobat e pa mbledhura nga vitet e mëparshme apo ato që janë në proces gjyqësor apo kanë kaluar në përmbarrim për ekzekutim.

21.GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT

Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **200,000 lekë**.

22.GJOBA TË D.T.T.V

Gjoba të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **200,000 lekë**, referuar dhe ecurisë të vitit aktual dhe detyrimeve të papaguara deri në vitin 2023 sipas informacionit që gjeneron sistemi i taksave dhe tarifave vendore.



BASHKIA KORÇË

23.QIRA OBJEKTI/TRUALLI/TOKË BUJQËSORE E.T.J

Qira objekti, trualli, tokë bujqësore, fondi pyjor e.t.j për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **9,017,585 lekë**, bazuar në numrin dhe sipërfaqen e objekteve dhe pronave që Bashkia ka lëshuar me qira dhe detyrimet e papaguara, referuar shkresës nr 8296 prot dt.19/10/2023 nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e detajuar si më poshtë:

- Qira objekti 2,521,080 lekë
- Qira trualli 6,396,844 lekë
- Qira tokë bujqësore 99,661 lekë

24.TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIM

Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **1,375,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

25.TARIFË PËR LEJË NDËRTIMI

Tarifë për lejë ndërtimi për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **700,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

26.TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE

Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **1,339,255 lekë** duke u bazuar në të dhënat e marra nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit e cila ka inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet që kanë zënë pronë publike në funksion të aktivitetit të tyre. Ky planifikim në masën **1,339,255 lekë** vjen si rezultat nga parashikimi i të ardhurave që do të mblidhen gjatë vitit 2024 në vlerën 842,951 lekë si dhe detyrimet nga debitorët në vlerën 496,304 lekë.

27.TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)

Të ardhura nga qiratë (banesa sociale) për vitin 2024 planifikohet në vlerën **7,050,000 lekë**. Parashikim ky i Njesisë së Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social, referuar shkresës nr 8296 prot dt.19/10/2023, e detajuar si më poshtë:

Nr	Banesa sociale CEB	Nr. Ap	Qira mujore	Qira vjetore	Debitorë	Totali
1	Banesa Nr.1	40	238,000	2,856,000	30,000	2,886,000
2	Banesa Nr.2	29	173,500	2,082,000		2,082,000
3	Banesa Nr.3	29	173,500	2,082,000		2,082,000
Total		98	585,000	7,020,000	30,000	7,050,000



BASHKIA KORÇË

28.TË ARDHURA NGA BANESA TË TJERA NË PRONËSI TË BASHKISË, BANESA SHTETËRORE

Të ardhura nga banesa të tjera në pronësi të Bashkisë, banesa shtetërore për vitin 2024 planifikohet në vlerën **84,000 lekë**. Parashikim ky i Njesisë së Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social, referuar shkresës nr 8296 prot dt.19/10/2023.

29.TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESA NË PRONËSI TË BASHKISË ENTI I BANESAVE)

Të ardhura nga qiratë (Banesa në pronësi të Bashkisë E.K.B) për vitin 2024 planifikohet në vlerën **2,349,944 lekë**.

Parashikim ky i Njesisë së Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social referuar shkresës nr 8296 prot dt.19/10/2023 konkretisht nga:

- Qira, banesa në pronësi të Bashkisë të dorëzuara nga E.K.B, 6 apartamente me vlerë vjetore 84,144 lekë.
- Të ardhura nga privatizimi për banesat sociale të dorëzuara nga E.K.B me vlerë vjetore 2,200,800 lekë.
- Debitorë, banesa në pronësi të Bashkisë të dorëzuara nga E.K.B, në vlerë 65,000 lekë.

30.KAMAT VONESA

Kamatvonesa për pagesë në vonesë të qirave për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **300,000 lekë**. Parashikim ky i Njesisë së Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social referuar shkresës nr 8296 prot dt.19/10/2023.

31.TARIFË PER DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE

Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **6,750,000 lekë**. Planifikimi i kësaj tarife është bërë nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit bazuar në të dhënat që disponon kjo drejtori referuar realizimit të vitit 2023 nga lejat e ndërtimeve për zërin “Gërmime dhe transport dheri dhe mbetje ndërtimore” si dhe parashikimit për vitin 2024.

32.TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SISTEMIT KULLUES

Tarifë vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **28,907,078 lekë** dhe zë **2.4%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2024 dhe **6.4%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.

Ky parashikim është bazuar në të dhënat dhe rezultatet e nxjera nga grupi i punës i ngritur enkas për të llogaritur sipërfaqen e tokave bujqësore, të cilave iu shërbejmë me kanale kulluese dhe rrugë parcelash, si dhe në informacionin e marrë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, referuar kostove për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kullimit, mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave, çakullimin e tyre, vendosjes së tombinove apo dhe çdo lloj shërbimi që kjo e fundit kryen në funksion të bujqësisë për vënien në funksionalitet të komplet sistemit.



BASHKIA KORÇË

Planifikimi në vlerën **28,907,078 lekë** përlogaritet nga:

- Parashikimi i të ardhurave që do të mbliidhen gjatë vitit 2024 bazuar në sipërfaqen prej **100,640 dynym** tokë bujqësore në vlerën **12,115,205 lekë**
- Detyrimeve debitore në vlerën **16,791,873 lekë**.

TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA

Taksat e ndara zenë 10.4 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen gjatë vitit 2024.

	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	Realizim 2021	Realizim 2022	Plani 2023	Realiz.11muaj 2023	I pritshëm	Plani 2024
1	TATIM SHITJEJE PASURI E PALUAJTSHME	22,932,304	20,402,161	25,000,000	5,902,199	7,194,580	25,000,000
2	TAKSË RREGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	43,262,884	44,057,543	47,000,000	41,760,551	46,397,568	55,000,000
3	RENTA MINERARE	331,454	549,188	700,000	440,756	461,865	700,000
4	TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE	22,090,739	24,932,778	35,000,000	23,499,042	31,499,042	45,000,000
	TOTALI	88,617,381	89,941,670	107,700,000	71,602,548	85,553,055	125,700,000

Taksat me peshën më të madhe janë:

- **Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve zë 4.6% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 43.8% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat e ndara.**
- **Tatim shitje pasuri e paluajtshme zë 2.1% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 19.9% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat e ndara.**
- **Tatim mbi të ardhurat personale zë 3.7% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 35.8% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat e ndara**

Më konkretisht po i detajojmë më poshtë:

1.TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për të gjitha pasuritë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë. Planifikimi për vitin 2024 do të jetë **25,000,000 lekë**, duke ju referuar të dhënave nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, e cila në rolin e agjentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor. Kjo taksë zë **2.1 %** të planifikimit total për vitin 2024.



BASHKIA KORÇË

2. TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitin 2024 është planifikuar **55,000,000 lekë** parashikim ky i bërë nga D.R.SH.T.R – Korçë, e cila referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, në rolin e agentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor. Ky parashikim është bërë nga D.R.SH.T.R-Korçë bazuar në realizimin e viteve paraardhëse, ndryshimet e fundit ligjore si dhe në të dhënat e disponuara për periudhën Janar – Nëntor të vitit 2023. Kjo taksë zë **4.6%** të planifikimit total për vitin 2024.

3. RENTA MINERARE

Çdo person fizik apo juridik, që është i licensuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrinë përgjegjëse për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Taksa e rentës minerare arkëtohet në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare. Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Për vitin 2024 kjo taksë planifikohet të aktëtohet në vlerën **700,000 lekë** bazuar nga të dhënat e mara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

4. TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2 (dy) për qind të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale që realizohen në juridiksionin e tyre. Deri në këto momente kjo ndarje bëhet sipas numrit të popullsisë të Bashkive të përdorur në formulën e transfertës së pakushtëzuar. Gjatë vitit 2024 do të njoftohet metodologjia përkatëse për shpërndarjen e tatimit mbi të ardhurat personale sipas juridiksionit të punojësve ku mblidhet tatimi. Për vitin 2024 ky tatim planifikohet të aktëtohet në vlerën **45,000,000 lekë** duke ju referuar të dhënave historike, planifikimit të vitit 2023, ecurisë të vitit 2023 duke i kombinuar me të dhënat e planifikuara në projekt buxhetin e vitit 2024 për Tatimin mbi të Ardhurat Personale. Ky tatim zë **3.7 %** të planifikimit total për vitin 2024.

7.2. Të ardhurat nga institucionet e vartësisë

Për vitin 2024 të ardhurat nga institucionet e vartësisë janë planifikuar në vlerën **38,818 mijë lekë** si më poshtë:



BASHKIA KORÇË

/lekë

Tabela 2: Burimet e financimit Institucionet e Varësisë (vlerat në 000/lekë)

Institucionet	PI 2023	Realizimi 11m 2023	PI I real të pritshëm 2023	PI 2024	DifPL24-PI23	%
QAK	2,650,000	2,063,230	2,304,000	2,650,000	-	100%
NSHMAC	24,000,000	12,037,714	13,200,000	32,000,000	8,000,000	133%
NSHP	2,787,000	2,493,347.5	2,900,000	4,055,000	1,268,000	145%
Qendra ditore	50,000	500	500	50,000	-	100%
Klubi shumesportesh	63,000	24,000	30,000	63,000	-	100%
Total	29,550,000	16,615,791.5	18,434,500	38,818,000	9,268,000	131%

7.3. Transferta e pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar do t'u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur. Për vitin 2024, transfera e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: a) pjesa e përgjithshme dhe b) pjesa sektoriale. Formula e shpërndarjes së transfertës garanton një sistem më të drejtë ekualizimi fiskal duke ndihmuar bashkitë me kapacitet më të ulët fiskal. Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrativo-territoriale. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale dhe rajonale. Gjithashtu, formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblihen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2024 është në vlerën 598,629 mijë lekë dhe krahasuar me vitin 2023 ka një rritje prej 66,567 mijë lekë ose 13%.




BASHKIA KORÇË

Tabela 3: Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme (vlerat në 000/lekë)

Emërtimi	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Dif PI 24-PI 23	% e rritjes
Transferta e pakushtëzuar	439,016	449,034	452,393	462,077	532,062	598,629	66,567	113%

Grafiku 1: Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme



Transferta e pakushtëzuar e vitit 2024 është në vlerën 598,629 mijë lekë dhe krahasuar me vitin 2023 ka një rritje prej 66,567 mijë lekë ose 12.5% më shumë dhe krahasuar me vitin 2022 ka një rritje prej 136,552 mijë lekë ose 29.5% më shumë.

7.4. Transfertat e pakushtëzuara sektoriale

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendorë”.

Funksionet nga transfertat e pakushtëzuara sektoriale jepen si më poshtë:

1. Arsim bazë dhe parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në QKF/punonjës mbështetës),
2. Konviktet e arsimit parauniversitar
3. Personeli jomësitor i arsimit parauniversitar,
4. Rrugët rurale,
5. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi,
6. Administrimi i pyjeve,




BASHKIA KORÇË

7. Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Tabela 4: Transfertat e pakushtëzuara sektoriale (vlerat në 000/lekë)

Emërtimi	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Dif PI 24-PI 23	% e rritjes
Arsimi bazë dhe parashkollor	174,671	175,003	189,254	194,261	199,821	218,767	18,946	109%
Konviktet e Arsimit Parauniversitar	21,881	21,881	21,881	22,114	20,413	23,461	3,048	115%
Personeli jomësimitor arsimit parauniversitar	18,289	18,289	18,838	19,592	22,778	23,132	354	102%
Mbrojtja nga zjarri dhe Mbrojtja Civile	29,092	29,092	29,964	31,163	32,730	35,124	2,394	107%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	13,815	13,815	15,197	15,805	16,375	18,075	1,700	110%
Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	43,178	43,178	45,737	47,566	49,100	51,897	2,797	106%
Rrjeti rrugor rural	6,522	6,522	6,522	7,067	7,265	8,094	829	111%
Transferta për rritjen e pagave					18,317	29,878	11,561	163%
Total transfertat e pakushtëzuara sektoriale	307,448	307,780	327,393	337,568	366,799	408,428	41,629	111%

Grafiku 2: Transferta e pakushtëzuar sektoriale



Fondet nga transfertat e pakushtëzuara sektoriale për vitin 2024 kanë një rritje prej 41,629 mijë lekë krahasuar me vitin 2023, ose 11% më shumë. Këtu përfshihet edhe fondi i transferuar për përballimin e rritjes së pagës, e cila ka filluar të zbatohet që në prill të vitit 2023.

Transferta e pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale për vitet 2025 dhe 2026 do të jetë në të njëjtin nivel me VKB nr. 104 datë 27.7.2023 "Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2024-2026 në nivel programi.



BASHKIA KORÇË

7.5.Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore

- 1.Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore e të tjera.
- 2.Për vitin 2024, Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore është pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2024 në programin “Emergjencat Civile”, në Ministrinë e Mbrojtjes.
- 3.Vlerësimi i projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, i cili kryesohet nga Drejtori i AKMC - Kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes, anëtar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore.
- 4.Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime midis projekteve të Fondit të Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
- 5.Thirrjet për aplikim në Fondin Parandalimit dhe Menaxhimin të Fatkeqësive Natyrore për vitin buxhetor 2024, mund të bëhen që në nëntor të vitit paraardhës deri në 31 Janar të vitit korent.
- 6.Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.
- 7.Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

BUXHETI SIPAS INSTITUCIONEVE

Tabela 5: Shpenzimet sipas institucioneve (vlerat në 000/lekë)

Emërtimi i institucioneve	Buxheti fillestar 2023	Buxheti i ndrysh 2023	Realizimi 11M 2023	Buxheti 2024	Dif PI 2024- PI fill 2023	Dif PI 2024- PI i ndrysh 2023	%PL24- PI23	%PI24- PI nd 23
Bashkia	929,476	928,410	547,353	1,009,652	80,176	81,242	109%	109%
NSHP	538,345	558,798	401,900	577,592	39,247	18,794	107%	103%
NSHMAC	470,964	484,102	351,450	502,486	31,522	18,384	107%	104%
QAK	83,147	85,028	67,471	102,916	19,769	17,888	124%	121%
KLB Shsp	49,137	49,719	39,323	54,368	5,231	4,649	111%	109%
Shtëpia e Foshnjës	5,205	5,205	1,429	4,355	(850)	(850)	84%	84%
QDZH	550	550	389	975	425	425	177%	177%
QRZH	655	655	456	925	270	270	141%	141%
Totali	2,077,479	2,112,467	1,409,771	2,253,269	175,790	140,802	108%	107%



BASHKIA KORÇË

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike është në vlerën 577,592 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 25.6% .

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 për Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes është në vlerën 502,486 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 22.3% .

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 për Klubin Shumësportësh është në vlerën 54,368 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 2.4%.

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 për Qendrën e Artit dhe Kulturës është në vlerën 102,916 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 4.6%.

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 për Bashkinë është në vlerën 1,009,652 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 44.8%.

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 për Shtëpinë e Foshnjës, Qendra ditore e Zhvillimit dhe Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit është në vlerën 6,255 mijë lekë dhe pesha specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 0.3%.

Buxheti vjetor 2024 përbën vitin e parë të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe sipas ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40, përfshin dokumentacionin bazë dhe dokumentacionin shoqërues si më poshtë:

8.Buxheti i Bashkisë Korçë sipas dokumentave bazë dhe shoqërues

8.1.Dokumentacioni bazë:

Tabela BV 1: Buxheti i Bashkisë 2024 sipas Programeve dhe Njësive Shpenzuese (në lekë) (Neni 40, Paragrafi 3.1.a i Ligjit 68/2017)

Kjo tabelë është pjesë e dokumentacionit bazë të buxhetit vjetor të Bashkisë për vitin 2024, i cili është në përputhje me Nenin 40 të Ligjit 68/2017.

Përshkrimi i tabelës: Tabela BV 1 paraqet buxhetin e Bashkisë Korçë për vitin 2024, duke e ndarë sipas programeve dhe njësive shpenzuese. Buxheti është ndarë në dy kategori: shpenzime korente dhe shpenzime kapitale.



BASHKIA KORÇË

Kodi	Programit	AA122	AB122	AC122	AD122	AE122	AF122	AG122	AH122	AI122	AJ122	AK122	Totale
Njësia Shpenzuese	Emërtimi i Programeve	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	Siguria Publike	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik Vendor	Mbrojtja e Mjedisit	Shërbimet Publike Vendore	Kultura, Sport dhe Argëtim	Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	Përkujdesi Social	Fondi Rezervë	Fondi Kontigjencë	Totale
	Totale Bashkia	412,442,912	58,841,560	75,984,742	204,088,552	693,913,659	157,284,841	480,383,396	83,563,309	66,766,500	10,000,000	10,000,000	2,253,269,471
	Korente	379,090,912	57,341,560	56,331,542	194,088,552	584,216,762	153,544,841	409,615,996	72,763,309	56,666,500	10,000,000	10,000,000	1,983,659,974
	Kapitale	33,352,000	1,500,000	19,653,200	10,000,000	109,696,897	3,740,000	70,767,400	10,800,000	10,100,000	0	0	269,609,497
2122001		412,442,912	58,841,560	75,984,742	204,088,552	116,321,897	0	50,900,000	10,560,000	60,511,800	10,000,000	10,000,000	1,009,651,463
Bashkia	Korente	379,090,912	57,341,560	56,331,542	194,088,552	16,330,000	0	900,000	560,000	50,411,800	10,000,000	10,000,000	775,054,366
	Kapitale	33,352,000	1,500,000	19,653,200	10,000,000	99,991,897	0	50,000,000	10,000,000	10,100,000	0	0	234,597,097
2122017		0	0	0	0	0	0	429,483,396	73,003,309	0	0	0	502,486,705
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të	Korente	0	0	0	0	0	0	408,715,996	72,203,309	0	0	0	480,919,305
	Kapitale	0	0	0	0	0	0	20,767,400	800,000	0	0	0	21,567,400
2122006		0	0	0	0	577,591,762	0	0	0	0	0	0	577,591,762
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	Korente	0	0	0	0	567,886,762	0	0	0	0	0	0	567,886,762
	Kapitale	0	0	0	0	9,705,000	0	0	0	0	0	0	9,705,000
2122007		0	0	0	0	0	102,916,225	0	0	0	0	0	102,916,225
Qendra e Artit dhe Kulturës	Korente	0	0	0	0	0	99,416,225	0	0	0	0	0	99,416,225
	Kapitale	0	0	0	0	0	3,500,000	0	0	0	0	0	3,500,000
2122009		0	0	0	0	0	54,368,616	0	0	0	0	0	54,368,616
Klubi Shumësportësh	Korente	0	0	0	0	0	54,128,616	0	0	0	0	0	54,128,616
	Kapitale	0	0	0	0	0	240,000	0	0	0	0	0	240,000
2122020		0	0	0	0	0	0	0	0	975,000	0	0	975,000
Qendra Ditore e Zhvillimit	Korente	0	0	0	0	0	0	0	0	975,000	0	0	975,000
	Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2122018		0	0	0	0	0	0	0	0	925,000	0	0	925,000
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	Korente	0	0	0	0	0	0	0	0	925,000	0	0	925,000
	Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2122015		0	0	0	0	0	0	0	0	4,354,700	0	0	4,354,700
Shtëpia e Foshnjës	Korente	0	0	0	0	0	0	0	0	4,354,700	0	0	4,354,700
	Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Korente	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Korente	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0



BASHKIA KORÇË

Tabela BV 2: Tavanet për çdo Program të Bashkisë Korçë për 2024-2026 (në lekë) (Neni 40, Paragrafi 3.1.b i Ligjit 68/2017)

Përshkrimi i tabelës: Kjo tabelë paraqet tavanet e PBA për çdo program të Bashkisë Korçë për vitet 2024-2026. Tavani është ndarë në kategori të ndryshme, përfshirë pagat dhe sigurimet, shpenzimet korente të tjera, dhe shpenzimet kapitale

Kodi	Emërtimi i Programeve	2024				2025				2026			
		Totali	Pago & Sigurime	Korente të tjera	Kapitole	Totali	Pago & Sigurime	Korente të tjera	Kapitole	Totali	Pago & Sigurime	Korente të tjera	Kapitole
AA1.12	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	412,442,912	172,683,600	206,407,312	33,352,000	360,586,000	160,941,000	166,545,000	31,100,000	363,938,000	162,550,000	160,288,000	31,100,000
AB1.12	Siguria Publike	58,841,360	46,787,000	10,574,580	1,500,000	60,428,000	50,084,000	10,342,000	0	60,951,000	50,585,000	10,366,000	0
AC1.12	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor	75,994,742	12,700,000	43,631,542	19,663,200	56,290,000	23,045,000	19,695,000	13,312,000	56,614,000	22,776,000	19,695,000	13,945,000
AD1.12	Mbrojtja e Mjedisit	204,088,552	3,970,000	190,118,552	10,000,000	211,752,000	4,773,000	191,979,000	15,000,000	212,800,000	4,821,000	192,979,000	15,000,000
AE1.12	Shërbimet Publike Vendore	683,913,659	286,994,252	290,222,510	109,696,897	703,238,000	282,654,000	280,686,000	139,718,000	749,530,000	285,681,000	284,380,000	179,469,000
AF1.12	Kultura, Sport dhe Argëtim	157,284,841	50,854,467	102,690,374	3,740,000	140,072,000	48,392,000	89,500,000	2,180,000	140,566,000	48,676,000	89,500,000	2,180,000
AG1.12	Arsimi (pa përfshirë Arsimin Parashkollor)	490,383,395	271,450,616	198,165,380	70,767,400	431,225,000	250,235,000	130,990,000	50,000,000	434,987,000	252,696,000	132,091,000	50,000,000
AH1.12	Arsimi / Mesëm / Përgjithshëm	83,568,309	40,935,309	31,828,000	10,800,000	108,090,000	36,590,000	40,000,000	31,500,000	108,450,000	36,885,000	40,085,000	31,500,000
AI1.12	Përkujdesi Social	66,766,500	41,840,700	14,825,800	10,100,000	71,328,000	36,297,000	20,031,000	15,000,000	71,800,000	36,680,000	20,140,000	15,000,000
AJ1.12	Fondi Rezervë	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	0
AK1.12	Fondi Kontingjencë	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	0
	Totali	2,253,288,471	936,195,944	1,048,464,030	269,609,497	2,162,967,000	883,211,000	971,946,000	297,810,000	2,209,628,000	901,710,000	869,722,000	338,194,000

Theksojmë se tavanet për vitet 2025 dhe 2026 janë në të njëjtin nivel sipas PBA 2024-2026, i rishikuar, miratuar me VKB nr. 129 datë 28.9.2023 "Mbi miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026, të rishikuar.

Tabela BV 3.1: Parashikimi i të Ardhurave 2024-2026 (në lekë) (Neni 40, Paragrafi 3.1.c i Ligjit 68.2017)

Kjo tabelë përmban parashikimin e të ardhurave të Bashkisë për vitet 2024-2026, të ndara sipas burimeve buxhetore dhe kategorive të ndryshme të taksave dhe tarifave. Tabela është e detyrueshme për të përgatitur dhe monitoruar parashikimet e të ardhurave të Bashkisë në përputhje me Ligjin 68/2017.

Tabela është e ndarë në katër seksione:



BASHKIA KORÇË

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	302,121	276,563	528,903	528,903	590,164	539,532	544,928
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	6,175	1,542	3,500	3,500	2,500	3,570	3,606
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	147,834	155,137	286,974	286,974	289,664	292,741	295,669
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	114,846	122,707	197,673	197,673	207,129	201,645	203,663
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	20,387	20,388	65,886	65,886	57,863	67,210	67,882
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	12,601	12,042	23,415	23,415	24,673	23,886	24,124
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	5,957	7,737	8,000	8,000	8,000	8,161	8,242
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	134,234	104,224	222,000	222,000	280,000	226,462	228,727
A.1.5	Taksa e tabelës	7,921	7,923	8,429	8,429	10,000	8,598	8,684
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe lotaritë vendore	-	-	-	-	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1	-	-	-	-	-	-	-
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2	-	-	-	-	-	-	-
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	94,695	112,784	160,039	160,039	162,498	163,257	164,889
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	22,932	20,402	25,000	25,000	25,000	25,503	25,758
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	43,263	44,058	47,000	47,000	55,000	47,945	48,424
A.2.3	Taksa e rentës minerare	332	549	700	700	700	714	721
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	22,091	24,933	35,000	35,000	45,000	35,704	36,061
A.2.5	Taksa të tjera	6,077	22,842	52,339	52,339	36,798	53,391	53,925
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	305,200	307,323	444,444	444,444	425,630	453,378	457,912
A.3.1	Tarifa me menaxhim të mbetjeve	160,894	160,015	225,946	225,946	202,768	230,487	232,792
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	82,404	82,557	139,000	139,000	104,484	141,794	143,212
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	1,189	987	2,112	2,112	2,156	2,154	2,176
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	77,301	76,471	84,834	84,834	96,128	86,539	87,404
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	35,365	35,004	51,258	51,258	57,582	52,290	52,813
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	16,743	16,066	28,610	28,610	27,988	29,186	29,478
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	198	182	396	396	601	404	408
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	18,424	18,756	22,252	22,252	28,993	22,700	22,927
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	23,731	23,211	32,144	32,144	38,216	32,790	33,118
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	9,756	9,620	15,619	15,619	15,484	15,933	16,092
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	198	182	396	396	521	404	408
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	13,777	13,409	16,129	16,129	22,211	16,453	16,618
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	59,498	62,873	69,516	69,516	68,960	70,913	71,622
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	10,233	8,976	5,000	5,000	6,755	5,101	5,152
A.3.5.2	Tarifa për dhënie licënsave, lejeve e autorizimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.5	Tarifa e licënsimit të veprimtarive të transportit	1,105	976	1,300	1,300	1,300	1,326	1,339
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licënsuara dhe vendparkime publike	20,567	19,396	22,000	22,000	22,000	22,442	22,667
A.3.5.7	Tarifa për dhënie licënsa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukte të saj	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.8	Tarifa për pyetje dhe kullotat	5,416	11,058	11,990	11,990	8,131	12,231	12,353
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksjat	1,118	1,175	900	900	2,005	918	927
A.3.5.10	Tarifa për zënie dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	20,993	21,244	27,266	27,266	27,699	27,814	28,092
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	66	48	1,060	1,060	1,070	1,081	1,092
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.1	Biblioteka	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.2	Muzeumet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.3	Teatri	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.7	Mensë (Konviktet)	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.8	Kopshtet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.9	Çerdhet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujëtjes dhe kullimit	9,931	9,002	36,568	36,568	28,907	37,303	37,676
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-
A.3.10	Tarifa të tjera	15,781	17,218	29,012	29,012	29,197	29,595	29,891
A.4	Të Ardhurat e Tjera	43,563	63,725	63,550	66,570	67,920	60,543	61,149
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	-	-	-	-	-	-	-
A.4.8	Sekuestrimet dhe Zhdëmtime	-	-	-	-	-	-	-
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	-	-	-	-	-	-	-
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	-	-	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Të tjera	43,563	63,725	63,550	66,570	67,920	60,543	61,149
B	Transferta nga Buxheti Qendror	794,165	850,045	880,544	913,732	1,007,057	946,257	980,749
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	453,082	462,077	532,062	532,062	598,629	590,771	621,708
B.2	Transferta e Kushtëzuar	-	50,400	-	18,317	29,878	-	-
B.2.1	Për funksionet e deleguara	-	-	-	-	-	-	-
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	-	50,400	-	18,317	29,878	-	-
B.3	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	341,083	337,568	348,482	363,353	378,550	355,486	359,041
C	Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
C.1	Huamarrja Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-	-
C.2	Huamarrja Afatgjatë	-	-	-	-	-	-	-
D	Trashëgimi nga Viti i Shkuar	135,673	191,202	-	194,322	-	-	-
D.1	Trashëgimi Pa Destinacion	103,815	128,502	-	123,467	-	-	-
D.2	Trashëgimi Me Destinacion	31,858	62,700	-	70,855	-	-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË		1,675,417	1,801,642	2,077,480	2,308,010	2,253,269	2,162,967	2,209,627



BASHKIA KORÇË

A. Të Ardhurat nga Burimet e Veta: Ky seksion përmban të ardhurat e Bashkisë që vijnë nga burimet e veta, të tilla si taksa lokale, tarifa vendore dhe të ardhurat e tjera të përfituara nga asetet, veprimtarite ekonomike, donacionet dhe të tjera burime vendore. Këtu janë të paraqitur nënkategori për çdo lloj.

B. Transferta nga Buxheti Qendror: Ky seksion përfshin të ardhurat që vijnë në formë transfertash nga Buxheti Qendror. Transfertat mund të jenë të kushtëzuara ose pakushtëzuara, dhe mund të jenë për funksionet e deleguara, projekte të veçanta, ose të tjera që janë të dhëna nga Buxheti Qendror.

D. Trashëgimi nga Viti i Shkuar: Ky seksion përmban të ardhurat që vijnë nga vitet e mëparshme, të cilat nuk janë përdorur në periudhat e mëparshme dhe janë vendosur si të ardhura pa destinacion ose me destinacion për vitet e ardhshme.

TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË: Ky total vjen nga të gjitha seksionet A, B, C dhe D dhe tregon të ardhurat totale nga të gjitha burimet e parashikuara që Bashkia pritet të marrë për çdo vit.

Tabela BV 3.2: Totali i Shpenzimeve të Bashkisë sipas kategorive ekonomike (në lekë) (Neni 40, Paragrafi 3.1.c)

Tabela 3.2 është përdorur për të paraqitur shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike dhe viteve ndryshme. Kjo tabelë është gjeneruar automatikisht nga të dhënat që janë transferuar nga Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Emërtimi i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Me Ndrush.	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga, Shpërblyme & Tjera Personeli	600	558,643.0	592,173.0	708,699.0	749,802.0	800,078.3	765,378.0	772,199.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	93,664.0	99,234.0	118,081.0	129,050.0	135,117.6	127,833.0	129,511.0
Korente te Tjera								
Mallra dhe Shërbime	602	544,720.0	579,271.0	733,184.0	765,617.0	827,045.7	772,993.0	778,728.0
Subvencion	603	9,999.0	9,999.0	11,259.0	11,106.0	11,342.0	11,300.0	11,300.0
Transferta të Brendshme	604	119,650.0	111,781.0	147,293.0	148,990.0	146,036.3	148,234.0	149,234.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	6,043.0	24,558.0	9,210.0	24,143.0	4,940.0	7,500.0	7,500.0
Te tjera huamarrje te brendshme (te dala)	166	41,860.0	40,931.0	41,261.0	39,866.0	38,000.0	11,919.0	2,960.0
Interesa per huamarrje te tjera te brendshme	651	3,555.0	2,502.0	1,600.0	2,996.0	1,100.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	20,000.0	16,603.0	20,000.0	20,000.0	20,000.0
Shpenzime Kapitale								
Shpenzime Kapitale te Patrupezuara	230	183.0	2,506.0	19,560.0	18,498.0	10,000.0	10,300.0	10,500.0
Shpenzime Kapitale te Trupezuara	231	105,899.0	144,366.0	267,333.0	401,339.0	259,609.5	287,510.0	327,694.0
Shpenzime transferimet kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendshme	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI		1,484,216.0	1,607,321.0	2,077,480.0	2,308,010.0	2,253,269.5	2,162,967.0	2,209,626.0

Për vitin 2024 shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore krahasuar me



BASHKIA KORÇË

planin e vitit 2023 kanë një rritje prej 108,416 mijë lekë ose 13% më shumë.

Shpenzimet korrente ku përfshihen shpenzimet operative, shërbime të mirëmbajtjes së programeve, subvencioni i transportit urban, shërbimet publike, punime dhe shërbime që do të kryhen nga NSHP, si dhe transfertat tek organizatat dhe transfertat tek individët, principali dhe interesi, për vitin 2024 krahasuar me planin e vitit 2023 kanë një rritje prej 84,658 mijë lekë ose 8.7% më shumë.

Shpenzimet për investime për vitin 2024 krahasuar me planin e vitit 2023 kanë një ulje prej 17,284 mijë lekë.

Totali i Shpenzimeve të Bashkisë sipas institucioneve (në mijë lekë)

Institucionet/vitet	PI 2024	PI 2025	PI 2026
Bashkia	1,009,651	975,888	1,014,590
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	577,592	567,182	575,738
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes	502,487	473,415	477,537
Qendra e Artit dhe Kulturës	102,916	88,791	89,168
Klubi Shumësportësh	54,369	51,281	51,388
Qendra Ditore e Zhvillimit	975	550	550
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	925	655	655
Shtëpia e Foshnjës	4,355	5,205	
Total	2,253,270	2,162,967	2,209,626

Tabela BV 4: Numri i punonjësve të përhershëm sipas Funkcioneve të Qeverisjes Vendore (Neni 40, Paragrafi 3.1.ç i Ligjit 68/2017)

Tabela përmban numrin e punonjësve të përhershëm sipas institucioneve dhe funksioneve të qeverisjes vendore dhe përqindjen e tyre në totalin e punonjësve të Bashkisë.

Tabela 6: Numri i punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të Bashkisë Korçë dhe funksioneve për vitin e ardhshëm



BASHKIA KORÇË

Kodi Buxhetor i Njesisë Shpenzuese	Emertimi i Njesisë Shpenzuese	2024	
		Numri i Punonjësve të Përhershëm	Numri i Punonjësve me Kontratë të përkohshme
2122001	Bashkia	393	
2122017	Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të	402	
2122006	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	399	58
2122007	Qendra e Artit dhe Kulturës	51	
2122009	Klubi Shumësportësh	14	1
2122020	Qendra Ditore e Zhvillimit		1
2122018	Qendra Rezidenciale e Zhvillimit		1
2122015	Shtëpia e Foshnjës	7	1
0	0		
0	0		
Total Bashkia		1,266	62

Kodi Funkcionit Qeverisë	Funkcionet Qeverisë	Numër Stafi	
		Numer	Perqindje
01	Shërbimet e Përgjithshme Publike	252	19.0%
03	Rendi dhe Siguria Publike	56	4.2%
04	Çështjet ekonomike	34	2.6%
05	Mbrojtja e mjedisit	6	0.5%
06	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	457	34.4%
07	Shëndetësia		0.0%
08	Argëtimi, kultura dhe feja	66	5.0%
09	Arsimi	402	30.3%
10	Mbrojtja sociale	55	4.1%
	TOTALI	1,328	100.0%

a) përrputshmërinë me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

Buxheti vjetor i Bashkisë Korçë vjen në përputhje me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore, rregulla mbi të cilat është hartuar dhe miratuar edhe paketa fiskale e vitit 2024.

Konkretisht, në gërmën "f", të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", ligjin 8519 datë 30.07.1999 "Për ujitjen dhe



BASHKIA KORÇË

kullimin”, i ndryshuar, ligjin 9385 date 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ligjin 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ligjin 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”.

8.2.Dokumentacioni shoqërues

a)Informacion të detajuar për shpenzimet, sipas klasifikimeve buxhetore;

*Tabela e detajuar për shpenzimet sipas klasifikimeve buxhetore bashkëngjitur materialit të buxhetit 2024, sipas tabelës nr. 1.

b)Tabela me listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program është pjesë e instrumentit të planifikimit financiar dhe pjesë e materialit të buxhetit.

c)Llogaritjen e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore, si pjesë e paketës fiskale të parashikuara në këtë buxhet vjetor po i pasqyrojmë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Llogaritja e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore /lekë

Nr.	Përshkrimi i Përjashtimit/Lehtësimit Fiskal	Njësi	Lekë/Njësi	Të Ardhurat Potenciale	Të Ardhura të Planifikuara	Efekti Financiar
1	<i>Lehtësimi me 20% te totalit të tarifave vendore te subjekteve që kanë 20-50 persona të punësuar.dhe ushtrojne aktivitet ne fushen e inst arsimore, ojf dhe ICT</i>	61				887,200
2	<i>Lehtësimi me 50% te totalit të tarifave vendore te subjekteve që kanë mbi 50 persona të punësuar.</i>	11				430,500
3	<i>Përjashtim nga pagesa e tarifave vendore te subjekteve që kanë mbi 100 persona të punësuar.</i>	9				848,000
4	<i>Përjashtim nga pagesa e tarifave vendore të gjitha OJF-të me aktivitet fetar</i>	16				544,000
5	<i>Përjashtim nga pagesa e tarifës për zënie të hapësirës publike për muajt Dhjetor, Janar dhe Shkurt.</i>	67				871,441
6	<i>Përjashtim nga pagesa e tarifave vendore të gjitha subjektet të cilat do të zhvillojnë për herë të parë aktivitet dhe regjistrohen nga studentë të diplomuar në universitete brenda dhe jashtë vendit gjatë 2 viteve paraardhëse</i>	1				21,500
7	<i>Përjashtim nga pagesa e tarifave vendore të gjitha subjektet të cilat do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e artizanatit.</i>	2				43,000
8	<i>Përjashtim nga pagesa e tarifave vendore të gjithë investitorët e huaj të cilët do të regjistrojnë dhe zhvillojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në Bashkinë e Korçës.</i>	3				159,300



BASHKIA KORÇË

9	<i>Përrjashtim nga pagesa e tarifave vendore të gjitha subjektet të cilat do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e ITC, në fushën e institucioneve arsimore private si dhe subjekte që do të ushtrojnë aktivitetin në fushën e arsimit privat plotësues dhe jo-plotësues, organizimit të trajnimeve dhe kualifikimeve në fusha të ndryshme profesionale .</i>	5			107,500
10	<i>Përrjashtim nga ndryshimi i tarifave të ndriçimit dhe gjelbërimit për familjet kryefamiljarët e të cilave përfitojnë vetëm pension pleqërie / pension social kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose dhe me persona në ngarkim të tyre që janë të pa aftë për punë</i>	4361			1,875,100
11	<i>Përrjashtim nga pagesa e taksës së ndërtesës familjet që përbëhen vetëm nga pensionistë.</i>	6114			10,985,301
12	<i>Përrjashtim nga pagesa e tarifave vendore për familjet, familja përbëhet nga 1 pensionist, kryefamiljari i të cilave përfiton ndihmë ekonomike, kryefamiljari e të cilave përfiton statusin e para-tetra plegjisë, kryefamiljari e të cilave përfiton statusin e verbërisë .</i>	4025			19,253,250
					36,026,092

ç)Lista e njësive shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

Listën e njësive shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore:

Nr.	Emërtimi i Njësisë Shpenzuese	Kodi Buxhetor i Njësisë Shpenzuese
1	Bashkia	2122001
2	Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes	2122017
3	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	2122006
4	Qendra e Artit dhe Kulturës	2122007
5	Klubi Shumësportësh	2122009
6	Qendra Ditore e Zhvillimit	2122020
7	Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	2122018
8	Shtëpia e Foshnjës	2122015

d)Objektivat kryesorë për vitin 2024 për buxhetin vendor:

- Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore me qëllim mundësimin e ofrimit cilësor të shërbimeve publike për qytetarët dhe me standarde të përcaktuara
- Harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, konform standardeve ndërkombëtare;
- Ruajtja e standardeve ligjore për buxhetimin mbi bazë produkti, programi dhe funksioni në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Monitorimi i mekanizmave që nxisin rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin.
- Nxitja e zhvillimi ekonomik lokal dhe ulja e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Përbushjen me sukses e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e arsimit.



BASHKIA KORÇË

- Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- Shtimi i aktiviteteve atraktive sportive.
- Parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja në shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut.
- Administrimi, qeverisja dhe mbrojtja e fondit pyjor dhe kullosor kombëtar, mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Krijimi i marrëdhënieve midis NJQV, pronarëve dhe biznesit privat për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor.
- Të mbrojtë dhe sigurojë përfituesit nga çdo lloj forme abuzimi.
- Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve.
- Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i veprave ujtitëse.

e)Informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe një analizë të elementeve të riskut, të cilat karakterizojnë këtë borxh;

Intesa Sanpaolo Bank.

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin Tetor është 49,000,000 lekë.

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin Dhjetor është 100,000,000 lekë.

Për vitin 2015 shuma e disbursuar në muajin Mars është 50,000,000 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë është: princiali në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 13,626,401.11 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Tetor 2014- Dhjetor 2023 janë paguar principal 43,397,305.03 lekë dhe interesi në vlerën 13,481,471.85 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë është: princiali në vlerën 100,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 27,739,659.62 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Dhjetor 2014- Dhjetor 2023 janë paguar principal 86,713,913.59 lekë dhe interesi në vlerën 27,117,796.83 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë është: princiali në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 12,630,723.46 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Mars 2015- Dhjetor 2023 janë paguar principal 43,348,078.29 lekë dhe interesi në vlerën 12,477,238.22 lekë.

CEB. (Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës)

Transhi I 2014-2023 shuma e disbursuar është 340,214 euro

Transhi II 2016-2025 shuma e disbursuar është 640,000 euro

Transhi III 2017-2026 shuma e disbursuar është 110,000 euro

Transhi IV 2018-2027 shuma e disbursuar është 101,386 euro

Sipas planit të pagesave të transhit të parë për periudhën Dhjetor 2014- Dhjetor 2023 janë paguar principal në vlerën 43,798,261.04 lekë (340,214.00 euro).

Sipas planit të pagesave të transhit të dytë për periudhën Shtator 2016- Dhjetor 2023 janë paguar principal në vlerën 64,774,400.00 lekë (512,000.00 euro).



BASHKIA KORÇË

Sipas planit të pagesave të transhit të tretë për periudhën Korrik 2017- Dhjetor 2023 janë paguar principal në vlerën 9,556,800.00 lekë (77,000.00 euro).

Sipas planit të pagesave të transhit të katërt për periudhën Mars 2018- Dhjetor 2023 janë paguar principal në vlerën 7,726,627.06 lekë (60,831.60 euro).

Kjo hua është përdorur për ndërtimin e banesave me qëllim social.

Emërtimi i bankës	Principal			Interesi			Total Detyrimi
	Për tu paguar	Princ. i paguar	Princ. i mbetur për tu paguar	Për tu paguar	Interes i paguar	Interesi i mbetur për tu paguar	Principali + Interesi
Intesa Sanpaolo Bank	200,000,000.00	173,459,296.91	26,540,703.09	53,996,784.19	53,076,506.90	920,277.29	27,460,980.38
CEB	152,058,160.78	125,856,088.78	26,202,072.00	0.00	0.00	0.00	26,202,072.00
TOTAL	352,058,160.78	299,315,385.69	52,742,775.09	53,996,784.19	53,076,506.90	920,277.29	53,663,052.38

	Plan	Paguar	Detyrimi për tu paguar
Principal	352,058,160.78	299,315,385.69	52,742,775.09
Interes	53,996,784.19	53,076,506.90	920,277.29
Total	406,054,944.97	352,391,892.59	53,663,052.38

Elementët e riskut që e karakterizojnë këtë borxh janë:

- ✓ Ndjekja e grafikut të përgatitur nga bankat me datat përkatëse për likuidimin e kësteve, parashikimi i fondeve për likuidimin e kësteve.
- ✓ Ndryshimi i normave të interesit në rritje.
- ✓ Sigurimi i informacionit të duhur, në kohën e duhur mbi normat e interesit, ndjekja e trendit të normës së interesit.
- ✓ Risku i kursit të këmbimit.
- ✓ Ndjekja me kujdes e raportimit, bisedime me bankën mbi kursin e këmbimit, si dhe ndjekja e trendit të kursit të këmbimit.

ë)risqet fiskale dhe masat mbrojtëse, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë;

Nr.	Programi Buxhetor / Objektiva që preket	Risqet e analizuar	Pasojat	Niveli i vlerësuar i riskut	Masat e parashikuara/propozuara për të adresuar risqet	Zotëruesi i Riskut	Niveli i Riskut pas trajtimit
1	Raportim financiar korrekt dhe brenda afateve	Mungesa e një strukture statistikore për hartimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore të domosdoshme për		i lartë	Vetëdijësimi i rëndësishë dhe impaktit që duhet të ketë një strukturë statistikore si pjesë përbërëse e Drejtorive dhe Institucioneve të Varësisë	Të gjitha Drejtoritë dhe Institucionet e Varësisë	mesatar



BASHKIA KORÇË

		treguesit e performances, realizimit të projekteve, raporteve të monitorimit etj.					
2	Raportim financiar korrekt dhe brenda afateve	Mosraportim në kohë dhe me cilësi për shkak të gabimeve të punonjësve që kanë kaluar në një pozicion të ri në detyrë, ose të punonjësve që kanë kaluar në një pozicion të ri pune		i lartë	Rekrutim i stafit të kualifikuar dhe me eksperiencë. Bashkëpunim midis stafit të brendshëm dhe punonjësve të rinj	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të gjitha Drejtoritë e tjera	mesatar
3	Parandalimi dhe minimizimi i detyrimeve të prapambetura	Krijimi i detyrimeve financiare të përcaktuara nga një kontratë, marrëveshje apo vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës në kontratë		i lartë	Ngritja e urdhërit të kryetarit. për mos rialokim të fondeve të mbetura vecanërisht pas proçesit të tenderimit. Evidentimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i detyrimeve të krijuara nga Bashkia dhe Institucionet të Varësisë, sipas udhëzimit 26, date 27.09.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e veteqeverisjes vendore"	Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Institucionet e Varësisë	mesatar

	Numri i References (Kategoria(të). Procesi & Procesi - Nr rendor i riskut)	RMO.PAV & MNA -2
IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE	KATEGORIA	Rregullator, Menaxherial, Operacional
	PROCESET	PAV - Parashikimi i të Ardhurave Vendore MNA - Vetëdeklarimi i të dhënave nga taksapaguesi/ Vlerësimi tatimor bazuar mbi të dhëna të plota.
	OBJEKTIVI	1. Parashikim realist dhe i thelluar i të ardhurave bazuar në ekspertizë, në bazën e tatueshme, deklaratimet tatimore të taksapaguesve për vitin aktual, duke konsideruar kostot e shërbimeve vendore dhe risqet që sjellin politikat e reja. 2. Zbatimi i procedurave të mbledhjes së detyrimeve tatimore duke siguruar rritjen e arkëtimeve të taksave të paguara brenda afateve, në bazë të deklaratimit të taksapaguesit dhe vlerësimit tatimor nga administrata e taksave vendore
	NGJARJA E RREZIKUT	Vlerësim i gabuar tatimor bazuar mbi të dhëna të pjesshme ose të pasakta.
	SHKAKU I RREZIKUT	Mungesa e dokumentacionit të plotë zyrtar ku mbështeten aktivitetet e planifikuara të mbledhjes, të zbatuara, të përfunduara, të mbetura: - Mungesa e bazës së të dhënave për pasurinë e paluajtshme/ njësive pronësore, Regjistri qëndror/kadastra fiskale akoma i paplotë, në përmirësim e sipër) - Mungesa e bazës së të dhënave të familjeve rezidente që marrin shërbime në territorin e bashkisë (Në database janë të përcaktuara nr i familjeve që kanë kontratë me UKKO dhe familje efektive që përfitojnë nga shërbimet). - Mungesa e burimeve njerëzore për të mbledhur informacionin në terren;



BASHKIA KORÇË

	IMPAKTI / PASOJA	<p>1. Mungesa e transparencës së procesit e cila sjell uljen e vullnetit të taksapaguesve për derdhjen vullnetare të detyrimeve.</p> <p>2. Parashikim i gabuar i të ardhurave vendore në buxhet qoftë në rritje fiktive ose në ulje të pajustificuar.</p> <p>3. Moserealizimi i objektivave për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat.</p>
	MASAT EKZISTUESE TE KONTROLLIT	<p>Cilat databaza: TAIS dhe Sistemi i UKKO Ka verifikime në terren.</p> <p>Kalkulimet sot bëhen duke ndërthurur informacionet e sistemeve elektronike dhe të dhënave nga terreni</p> <p>Ka ndërveprim me QKB për taksapaguesit biznes</p> <p>Ka qasje në rregjistrin e gjëndjes civile për familjet.</p> <p>Është i përcaktuar nr. i familjeve rezidente dhe ato që marrin shërbime nga Bashkia; bazuar në informacionet e GJCV, Rajoneve dhe Njësive administrative</p> <p>Ka Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar</p> <p>Ndërveprohet me institucionet e tjera për të siguruar infomacionin e duhur</p>
ANALIZA E RREZIQEVE	Mundesia (1-5)	4
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	12
	Prioriteti i rrezikut	I LARTE
VLERESIMI	Pershtatshmeria e masave ekzistuese	<i>Të pamjaftueshme</i>
	VEPRIMI	Trajtim dhe monitorim. Mbahet nën kontroll pas reduktimit të masës së riskut.
MENAXHIMI / MASAT PER ZBUTJEN E RREZIQEVE	MASA SHITESHE PER TRAJTIMIN	<p>1. Të plotësohet rregjistri me të dhënat reale të taksave dhe tarifave vendore, nëpërmjet aksesimit/marrjes së informacionit të të dhënave të institucioneve të tjera (me AKSH-in në rastin e operimit me sistem IT taksash, QKB, etj). Në afatshkurtër përdorimi i formatit excel për rregjistrim dhe monitorim. – Afati menjëherë, kohëzgjatja 1 vit.</p> <p>2. Të specifikohen masat për secilën bazë të dhënash sipas llojit të taksave dhe tarifave. – Afati paralel me masën 1.</p> <p>- Për taksën e ndërtesës plotësimi në komunikim me kadastrën fiskale si dhe verifikimet në terren.</p> <p>-Për taksën mbi tokën bujqësore, në bashkëpunim me kadastrën bujqësore në bashki (dhe departamentet përkatëse në Qark)</p> <p>- Për bizneset komunikohet me QKB dhe verifikohet në terren, - Për familjet bazuar (i) në rregjistrin e gjëndjes civile, (ii) vizitave shtëpi më shtëpi dhe (iii) rakordimit me drejtoritë që ofrojnë shërbimet vendore, përcaktohen familjet rezidente dhe ato që marrin shërbimet publike nga bashkia.</p> <p>3. Të vlerësohet mjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore për procesin dhe të zhvillohen sisteme IT lokale (rregjistrat elektronike)– Afati brenda 2 viteve</p>
	FORMA E MASAVE	<p>1. Dokumenti i procesit për standartizimin e vjeljes së taksave dhe tarifave.</p> <p>2. Korrespondencë me institucione të tjera.</p> <p>3. Rregjistri elektronik me databazën e të dhënave reale të taksave dhe tarifave vendore.</p> <p>4. Verifikime në terren.</p> <p>5. Kërkesa buxhetore për fonde.</p>
	BURIMET QE KERKOHEN	<p>Burimet ekzistuese të bashkisë. Drafti i Dokumentit është hartuar më asistencë nga projekti SECO.</p> <p>Aplikimi për projekte dhe kontribute me fonde nga donatore/ huamarrje.</p> <p>Fonde financiare shtesë në PBA për përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe softëare/paisje TI (në pamundësi të donacionit apo projekteve me lart).</p>
	PRONARI I RREZIKUT	Kryetari i Bashkisë. Këshilli bashkiak për fondet e PBA.
	DATA E PERFUNDIMIT	Menjëherë për miratimin e aktit rregullativ dhe dokumentin e procesit. Afati i fundit pas 2 vitesh (përfshi zhvillimin dhe kompletimin e rregjistrave elektronike.



BASHKIA KORÇË

NDERLIDHJE ME STRUKTURA/ INSTITUCIONE TE TJERA	Drejtoritë e bashkisë që ofrojnë shërbimet publike, Drejtoria e Financës, sektori IT, sektori i prokurimit. Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, AKSHI, QKB, Zyra e rregjistrimit të pasurive, etj.
STATUSI I RREZIKUT PAS MASES SE MARRE	MESATAR

f)një përmbledhje të të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë;

Tabela 8: Përmbledhje e të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë (Lekë)

Shoqëria: Korça 2008 sh.a		Shoqëria: Tregu I Shitjes Me Shumice Fruta Perime Korçë	
Përqindja e pjesëmarrjes së Bashkisë:	100%	Përqindja e pjesëmarrjes së Bashkisë:	100%
Emërtimi	2024	Emërtimi	2024
Të ardhura Gjithsej	7502640	Të ardhura Gjithsej	17461600
<i>Të ardhura nga shitja (tarifa)</i>		<i>Të ardhura nga shitja (tarifa)</i>	
Subvencione Gjithsej		Subvencione Gjithsej	
<i>Subvencion/Kredi 1</i>		<i>Subvencion/Kredi 1</i>	
<i>Subvencion/Kredi 2</i>		<i>Subvencion/Kredi 2</i>	
Shpenzimet Gjithsej	5561927	Shpenzimet Gjithsej	16735120
<i>Kosto mallrave & shërbimeve</i>	3751320	<i>Kosto mallrave & shërbimeve</i>	4496000
<i>Shpenzime operative</i>	1738607	<i>Shpenzime operative</i>	11739120
<i>Shpenzime financiare (interesa, etj.)</i>		<i>Shpenzime financiare (interesa, etj.)</i>	
<i>Shpenzime për taksa</i>		<i>Shpenzime për taksa</i>	
<i>Shpenzime të tjera</i>	72000	<i>Shpenzime të tjera</i>	500000
Fitimi / Humbja	1940713	Fitimi / Humbja	726480

g) Projekti i parë të planit të arkës së projektbuxhetit, të paraqitur për miratim, pjesë e Instrumentit të Planifikimit Financiar 2024-2026;

gj) Një përmbledhje të pagesave të vonuara ndaj palëve të treta, përfshirë edhe origjinën e tyre dhe masat për likuidimin e parandalimin e krijimit të tyre.

	2023		2023	
	Viti aktual		Viti aktual	
Kreditor	Stoku i borxhit, 31 Tetor		Amortizimi i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor
Shpenzime Korrente	0		0	0
Mallra dhe shërbime	138,853		138,853	0
Paga dhe sigurime	0		0	0
Të tjera	0		0	0
Shpenzime Kapitale	0		0	0
Institucione buxhetore	0		0	0
Subjekte private	4,198,040		4,198,040	0



BASHKIA KORÇË

Vendime Gjyqësore	0	0	0
Marrëdhënie pune	0	0	0
Mallra dhe shërbime	0	0	0
Innvestime	0	0	0
Të tjera	56,850,274	56,850,274	0
Total	61,187,167	61,187,167	0

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme për periudhën janar-tetor 2023 vlera e detyrimeve të prapambetura që u kaluar afati 60 ditor është 61,187,167 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga:

-138,853 lekë detyrime të prapambetura të Shtëpisë së Foshnjës, të cilat nuk janë shlyer për mungesë dokumentacioni.

-4,198,040 lekë pagesë TVSH për objektin Shfrytezimi Inteligent I Energjise (projekti i efijencës së energjisë). Kjo vlerë është detyrimi i MIE (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), sipas marrëveshjes dhe kontratës për këtë objekt. Pagesa do të kryhet në momentin e çeljes së fondit nga MIE.

-56,850,274 lekë janë vendime gjyqësore për personat PAK detyrimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pagesat e vendimeve gjyqësore u kryen gjatë muajit nëntor 2023 me çeljen e fondeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

9 BUXHETI I BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2024, 2025 DHE 2026

Shpenzime për personelin	274,587 mijë lekë
Shpenzime korrente	461,368 mijë lekë
Shpenzime për investime	234,597 mijë lekë
Interesi dhe principali	39,100 mijë lekë

Total **1,009,652 mijë lekë**

Shpenzimet për personelin (600+601) për vitin 2024, duke përfshirë të gjitha programet e Bashkisë dhe funksionet do të jenë në vlerën 274,587 mijë lekë, krahasuar me planin e vitit 2023 ka një rritje prej 27,600 mijë lekë ose në masën 11% dhe krahasuar me planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një rritje prej 15,984 mijë lekë ose 6%. Kjo rritje vjen si rezultat i zbatimit të VKM nr 326 datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, kategoritë e pagave nga klasa I deri XIII pësuan ndryshime, VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV”, VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 240 datë 20.04.2023 “Për një ndryshim në VKM nr. 350 datë 19.4.2017, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ndryshuar.

Shpenzimet korrente (602-609) për vitin 2024, duke përfshirë të gjitha programet e Bashkisë do të jenë në vlerën 461,368 mijë lekë, krahasuar me planin e vitit 2023, ka një rritje prej 62,306 mijë lekë ose



BASHKIA KORÇË

në masën 16% dhe krahasuar me planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një rritje prej 62,337 mijë lekë ose 16%. Këtu përfshihen fondet për shërbimin e pastrimit, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve, shërbimi urban, shpenzimet operative, mirëmbajtje, materiale ndërtimi, projektet turistike, transfertat tek organizatat, transfertat tek individët, fondi i emergjencave civile, fondi rezervë dhe ai i kontigjencës , etj. Të gjitha këto shpenzime jepen të detajuara në matricën e shpenzimeve bashkangjitur materialit.

Shpenzimet për investime (230-231) për vitin 2024, duke përfshirë të gjitha programet e Bashkisë do të jetë në vlerën 234,597 mijë lekë dhe krahasuar me planin e vitit 2023 ka një ulje prej 5,969 mijë lekësh ose në masën 2.5%.

Shpenzimet për principalin dhe interesin (166-651) për vitin 2024, do të jetë në vlerën 39,100 mijë lekë si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi	Principal	Interesi
Intesa SanPaolo Bank	26,540.71	1,100.00
Ministria e Financave (CEB)	11,459.29	
Total	38,000.00	1,100.00

Detajimi i buxhetit të Bashkisë sipas programeve, kategorive ekonomike dhe produkteve për vitet 2024, 2025 dhe 2026

9.1. Programi: Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi AA122

9.1.1. Vështrim i përgjithshëm

Ky program merret me zhvillimin e njësisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun, shërbime në mbështetje të Kryetarit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore ose të Këshillit. Pjesë e këtij programi janë:

Funksioni i planifikimit, menaxhimit, administrimit, çështje financiare dhe fiskale, shërbimi i borxhit të brendshëm, transparenca publike, planifikimi urban vendor dhe funksioni i sportit dhe argëtimit të cilat menaxhohen nga Bashkia.

9.1.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin. Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumentave dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësi, zyrave të printimit dhe IT etj.

Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për Kryetarin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë. Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore.

Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit. administrimin e çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale, menaxhimin e fondeve të njësisë së vetëqeverisjes etj., operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit.

Gjithashtu ky program përfshin marrëdhëniet e njësisë vendore me kreditorët dhe shërbimin e borxhit të brendshëm të njësisë vendore, pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore, amortizimi



BASHKIA KORÇË

i huave të marra etj., përfshin zhvillimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e planeve të zhvillimit urbanistik.

Lëshimin e lejeve për ndërtime të reja, zhvillimin e tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Planifikim i përgjithshëm, duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e Planeve të Përgjithshme Vendore/Planeve të Zhvillimit Strategjik, si dhe hartimin e planeve të zonimit dhe të rregullave të ndërtimit.

Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi vrapimi, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj.); mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive; Mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me tabelë etj.);

Buxheti për këtë program është 412,443 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli	172,684 mijë lekë
- shpenzime korrente	206,407 mijë lekë
- shpenzime për investime	33,352 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2024 për këtë program do të jetë në vlerën 147,584 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 25,100 mijë lekë.

Në këtë program përfshihen produktet si më poshtë:

V111AAA Shërbimi i stafit të Administrimit dhe Menaxhimit. Këtu përfshihen shërbimet e dhëna nga Kryetari, Nënkryetarët, kabineti, sekretari i përgjithshëm, drejtuesit dhe specialistët e lidhur me funksionet mbështetëse të NJVQV si Burimet Njerëzore, Financa, IT, Juridike, Prokurime, Audit, etj. (përfshirë QKR, QKB, NJA, kryepëlyqetë). Pagesa e pagave dhe sigurime apo honorare për stafin. V111AAB Akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak. Shërbime të ofruara nga Këshilli Bashkiak dhe stafi i tij kundrejt administratës dhe komunitetit. Pagesa e honorareve për anëtarët e KB dhe shpenzimeve të tjera për funksionimin e KB.

V111AAD Mirëmbajtja e infrastrukturës dhe Funksionimi i Aparatit të Bashkisë. Funksionimi dhe mirëmbajtja e Infrastrukturës fizike të bashkisë përmes sigurimit të shpenzimeve korente apo kapitale për ujë, energji elektrike, internet, telefon, mirëmbajtje, kancelari, karburant dhe mirëmbajtje për mjetet e transportit, pajisje apo furnitura të tjera IT, etj.

V112AAB Subjekte tregtare të Inspektuara. Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me Drejtorinë e të Ardhurave (apo Taksave Vendore), duke filluar nga kostot e personelit; shpenzime korente apo kapitale për funksionimin (utilitare, karburant, kancelari, etj.) apo mirëmbajtje (automjetesh apo infrastrukturë tjetër fizike); shpenzimet për dieta, transport, etj.; shpenzime për promovime apo fushata sensibilizuese; shpenzimet për barrën siguroese dhe hipotekore, urdhra bllokimi, pagesa per RBS nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, etj.

V614AAB Inspektime të zhvilluara për mbrojtjen e territorit. Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet inspektuese dhe shpenzimet përkatëse të kryera nga inspektoriatet e ndërtimit. Shpenzimet janë për paga dhe sigurime për stafin e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, si edhe shpenzime të tjera të operimit të shërbimit.



BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë program është në vlerën 75,677 mijë lekë

Fondi i planifikuar për transfertat për organizatat për këtë program është 91,631 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për këtë program është në vlerën 33,352 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shlyerjen e principalit dhe interesit të kredisë është 39,100 mijë lekë.

Të gjitha shpenzimet e detajuara sipas llogarive ekonomike, për vitet 2021-2026 paraqitet si më poshtë:

000/lekë

PBA 2024-2026								
(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK								
Programi	AA122	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime		105,891.0	119,377.0	143,859.0	152,184.0	172,683.6	160,941.0	162,550.0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	90,769.0	102,308.0	123,259.0	130,380.0	147,583.6	137,910.0	139,289.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	15,122.0	17,069.0	20,600.0	21,804.0	25,100.0	23,031.0	23,261.0
Shpenzime Korente të Tjera		150,202.0	167,763.0	201,550.0	209,445.0	206,407.3	168,545.0	160,288.0
Mallra dhe Shërbime	602	38,052.0	54,714.0	75,455.0	73,758.0	75,676.6	68,392.0	69,094.0
Subvencion	603					0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	66,595.0	67,052.0	83,234.0	92,552.0	91,630.7	88,234.0	88,234.0
Transferta të Jashtme	605					0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	140.0	2,564.0		273.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	41,860.0	40,931.0	41,261.0	39,866.0	38,000.0	11,919.0	2,960.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	3,555.0	2,502.0	1,600.0	2,996.0	1,100.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale		11,736.0	14,769.0	32,423.0	44,545.0	33,352.0	31,100.0	31,100.0
Aktive të Patrupëzuara	230		2,506.0	10,300.0	10,270.0	10,000.0	10,300.0	10,500.0
Aktive të Trupëzuara	231	11,736.0	12,263.0	22,123.0	34,275.0	23,352.0	20,800.0	20,600.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		267,829.0	301,909.0	377,832.0	406,174.0	412,442.9	360,586.0	353,938.0

Matrica e shpenzimeve operative analitike, produkteve dhe matrica e shpenzimeve për investime paraqitet sipas tabelës nr. 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

9.2. Programi: Siguria publike AB 122

9.2.1 Vështim i përgjithshëm:

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Masa të njësisë së vetëqeverisjes vendore për të rritur besimin e qytetarëve dhe marrëdhënien e njësisë me komunitetin. Për qëllime bashkëpunimi njësia vendore planifikon aktivitete të cilat ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve sa më



BASHKIA KORÇË

afër kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, si dhe garantimin e shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse;

Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përbalimi i emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

9.2.2 Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;

Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë

Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;

Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;

Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;

Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse;

Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimit malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj. Buxheti i planifikuar për vitin 2024 do të jetë 58,842 mijë lekë, nga të cilat 35,124 mijë lekë janë nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për MNZ-në, e detajuar si më poshtë:

Shpenzime personeli	46,767 mijë lekë
Shpenzime korrente	10,575 mijë lekë
Shpenzime për investime	1,500 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2024 për këtë program do të jetë në vlerën 40,052 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 6,715 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë program është në vlerën 7,575 mijë lekë

Fondi i planifikuar për transfertat tek individët për këtë program është 3,000 mijë lekë, ku përfshihet fondi i emergjencave civile, i planifikuar nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore. Përdorimi i këtij fondi bëhet me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për këtë program është në vlerën 1,500 mijë lekë.

Produktet e përdorura tek ky program janë:

V314AAB Patrullim për sigurinë publike. Ky produkt përfshin të gjitha aktivitetet e Policisë Bashkiake në lidhje me inspektimet për parandalimin e kundravajtjeve administrative (shpenzime karburant, automjete, uniforma); Kostot e personelit të policisë bashkiake (paga dhe sigurime), etj.

V328AAB Shërbime të mbrojtjes civile. Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile.

V328AAC Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit. Ky produkt ka të bëjë me krijimin e gadishmërisë së duhur njerëzore, mjete dhe materiale për t'ju përgjigjur në kohë rasteve të zjarrit dhe shpëtimit në objekte banimi, pyje dhe kullota, aksidente në rrugë, etj. Këtu do të përfshihen njëkohësisht edhe aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me marrjen e masave parandaluese të zjarrit apo aksidenteve, përfshirë mjete apo materiale të nevojshme si dhe fushata të ndryshme



BASHKIA KORÇË

sensibilizuese.

000/lekë

PBA 2024-2026								
(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK								
Programi		AB122	Siguria Publike					
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime		34,295.0	35,974.0	44,660.0	45,761.0	46,767.0	50,084.0	50,585.0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	29,388.0	30,820.0	38,250.0	39,186.0	40,052.0	42,917.0	43,049.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	4,907.0	5,154.0	6,410.0	6,575.0	6,715.0	7,167.0	7,536.0
Shpenzime Korente të Tjera		5,466.0	7,111.0	10,302.0	13,762.0	10,574.6	10,342.0	10,366.0
Mallra dhe Shërbime	602	3,819.0	5,253.0	7,302.0	7,405.0	7,574.6	7,342.0	7,366.0
Subvencion	603					0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604					0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605					0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	1,647.0	1,858.0	3,000.0	6,357.0	3,000.0	3,000.0	3,000.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale		348.0	9,618.0	4,128.0	18,075.0	1,500.0	0.0	0.0
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	348.0	9,618.0	4,128.0	18,075.0	1,500.0	0.0	0.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		40,109.0	52,703.0	59,090.0	77,598.0	58,841.6	60,426.0	60,951.0

Matrica e shpenzimeve operative analitike, produkteve si dhe matrica e investimeve paraqitet sipas tabelës nr. 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

9.3. Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik AC122

9.3.1. Vështim i përgjithshëm

Ky program përfshin funksionet për mbështetjen dhe Zhvillimin Ekonomik: si shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve, zhvillimin e tregjeve, administrimin e pyjeve dhe kullotave si dhe projektet në fushën e turizmit.

Në këtë program përfshihet mbështetja dhe promovimi i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore, administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të grandeve për bujqësinë e



BASHKIA KORÇË

zhvillimit rural, kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorit. Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinarë për blegtorinë. Në këtë program përfshihen fondet nga funksioni i transferuar që nga viti 2016 i administrimit të pyjeve. Ky funksion merret me administrimin e çështjeve dhe shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, mbikqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore dhe dhënia e licencave për prerje pemësh. Gjithashtu ky shërbim merret me shpërndarjen e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes. Ky program merret me nxitjen e projekteve zhvillimore që kanë për qëllim rritjen ekonomike e turizmin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, si dhe zhvillimin dhe promovimin e turizmit.

9.3.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

Funksionimi ose mbështetja me politika vendore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë;

Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ;

Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj;

Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj;

Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikën e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin.

Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve;

Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë.

Ndërtim, mirëmbajtje, zgjerim, përmirësim dhe funksionim i strukturave përkatëse me qëllim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor për njësinë vendore;

Hartimi dhe monitorimi i projektve që kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor;

Funksionimi i zyrave turistike vendore, organizim i fushatave publicitare, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaturës promovuese e të një natyre të ngjashme;

Përmirësim i hapësirave pamore urbane të njësisë, përmes mirëmbajtjes së objekteve kulturore dhe turistike që nxisin rritjen e vizitorëve duke e kthyer në atraksion turistik njësinë vendore.

Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave;

Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore;

Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve;

Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë;

Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit



BASHKIA KORÇË

bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë;
Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural;
Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit;
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;
Administrim i fondit pyjor dhe kullësor publik;
Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh;
Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit, si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë;
Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;
Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore;
Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes.

Buxheti i planifikuar për programin mbështetja për zhvillimin ekonomik është 75,985 mijë lekë, nga të cilat 18,075 mijë lekë nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për administrimin e pyjeve dhe kullotave, si më poshtë:

Shpenzime personeli	12,700 mijë lekë
Shpenzime korrente	43,632 mijë lekë
Shpenzime për investime	19,653 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2024 për këtë program do të jetë në vlerën 10,880 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 1,820 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë program është në vlerën 43,632 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për këtë program është në vlerën 19,653 mijë lekë.

Produktet e përdorura tek ky program janë:

V426AAA Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullësor. Ky produkt përshin pagesën e pagave dhe sigurimeve për sektorin e monitorimit dhe mbrojtjes së tokës dhe pyjeve.

V426AAB Inspektim dhe kontroll i sipërfaqes pyjore/kullësore. Ky produkt përfshin aktivitetet e inspektimit të të gjitha hapësirave kullësore dhe pyjore për prerje të paligjshme të lëndës drusore duke marrë parasysh hapësirat e shfrytëzuara dhe ato të pashfrytëzueshme, si edhe kostove të nevojshme të lidhura me funksionimin e këtij shërbimi.

V426AAE Sipërfaqe pyjore e rehabilituar. Ripyllëzimi i sipërfaqeve të djegura dhe sipërfaqeve të eroduara duke investuar në pyje me standartin 1667 fidanë/ha sipas skemës 3mx2m; sistemime malore me gabiona dhe mure guri; etj.



BASHKIA KORÇË

000/lekë

PBA 2024-2026

(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK

Programi		AC122	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik Vendor					
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	2021 Fakti	2022 Fakti	2023 Buxheti Fillestar	2023 Buxheti Pritshëm	2024 Plani	2025 Plani	2026 Plani
Paga & Sigurime		10,055.0	10,013.0	20,602.0	21,740.0	12,700.0	23,045.0	22,776.0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	8,620.0	8,587.0	17,600.0	18,554.0	10,880.0	19,747.0	19,445.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	1,435.0	1,426.0	3,002.0	3,186.0	1,820.0	3,298.0	3,331.0
Shpenzime Korente të Tjera		15,861.0	13,954.0	19,331.0	21,188.0	43,631.5	19,893.0	19,893.0
Mallra dhe Shërbime	602	13,349.0	13,654.0	19,331.0	21,140.0	43,631.5	19,893.0	19,893.0
Subvencion	603					0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	2,429.0				0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605					0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	83.0	300.0		48.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166					0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651					0.0	0.0	0.0
Rezervat	609					0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale		37,711.0	71,470.0	17,850.0	85,533.0	19,653.2	13,312.0	13,945.0
Aktive të Patrupëzuara	230			9,260.0	8,108.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	37,711.0	71,470.0	8,590.0	77,425.0	19,653.2	13,312.0	13,945.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		63,627.0	95,437.0	57,783.0	128,461.0	75,984.7	56,250.0	56,614.0

Matrica e shpenzimeve operative, produktet dhe matrica e investimeve paraqiten sipas tabelës nr. 2 dhe 3 bashkangjitur materailit.

Detajimi i projekteve në programin “Zhvillimi i Turizmit”

Titulli i projektit : “KORÇA SNOW FEST”

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Turizmi i dëborës duket se është shndërruar së fundmi në një nga tendencat më të pëlqyera të shqiptarëve, por sidomos të vizitorëve të huaj, të cilët janë të apasionuar pas aktiviteteve sportive në natyrë. Destinacionet turistike dimërore më të bukura në Korçë, po bëhen së fundmi destinacioni i synuar fort, pas ndërtimit të hoteleve dhe fshatrave turistike modernë. Korça Snow Fest është një ndër



BASHKIA KORÇË

eventet më të veçanta që promovon sportet e borës gjatë muajve të dimrit. Eventit që do të realizohet në bashkëpunim me Federatën Botërore të Skive (FIS), ka synim të promovojë sportin e skive përmes aktiviteteve argëtuese për të gjithë grupmoshat, të zhvilluar në Pistën e Skive në Dardhë. Kur bëhet fjalë për dimrin, aktivitetet dimërore janë ato që tërheqin vëmendjen e mijëra vizitorëve, sidomos të huaj, të cilët kanë mundësi jo vetëm të shijojnë një botë fantastike dëbore dhe drite, por të shijojnë ushqimin tradicional, pijet e ngrohta, si edhe muzikën më të mirë që do të shoqërojë eventin.

Qëllimi: Zhvillimi i turizmit në rajon përmes promovimit të sportit të skive në destinacionet turistike rreth Korçës në bashkëpunim me Federatën e Skive, si edhe rritja e interesit të vizitorëve për këtë sport.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj përmes krijimit të zgjedhjeve alternative të argëtimit për vizitorët vendas dhe të huaj.
- Përfshirja dhe promovimi i bizneseve lokale në festë.
- Rritje të impaktit direkt dhe indirekt në rritjen e të ardhurave të bizneseve të rajonit e më gjerë.

Kostoja Totale: 3,000,000 lekë

Titulli i Projektit: BALLKAN FEST

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Festivali ballkanik i muzikës folklorike dhe moderne, që organizohet prej më shumë se dy vitesh në Korçë, këtë vit do të zhvillohet në përmasa akoma më të mëdha. Eventit do të jetë jetë jetë një aktivitet i madh ballkanik, me pjesëmarrjen edhe të bandave të njohura jo folklorike nga vende të ndryshme të Ballkanit. Festivali bën bashkë pjesëmarrës nga të gjitha vendet e Ballkanit, interpretues nga shoqëritë kulturore dhe artistike nga vendet fqinje, Shqipëria, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, si dhe të ftuar specialë. Ruajtja e elementëve të trashëgimisë kulturore dhe diversitetit kulturor mes grupeve pjesëmarrëse do të shpalojë përmes eventit më të madh ballkanik të folkut dhe muzikës bashkëkohore për të gjithë banorët, por edhe vizitorët vendas e të huaj që vijnë në Korçë.

Qëllimi: Promovimi dhe ruajtja e këngëve tradicionale, folklorit, muzikës modern jo folklorike, diversitetit kulturor dhe trashëgimisë kulturore.

Kostoja Totale: 1,500,000 lekë

Titulli i Projektit: ÇELJA E SEZONIT TURISTIK

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Korça është një ndër destinacionet turistike të frekuentuara gjatë muajve të verës. Në kuadër të çeljes së sezonit turistik veror, Bashkia Korçë ka planifikuar të zhvillojë koncerte me muzikë live në qendër të qytetit, me pjesëmarrjen e këngëtarëve të njohur të muzikës shqiptare. Si çdo vit sezoni turistik në Korçë pret shumë vizitorë, duke qenë se në muajin qershor në Korçë organizohet Festivali Ndërkombëtar i Karnavaleve, i cili mirëpret grupe pjesëmarrëse nga Ballkani e Europa. Performancat muzikore në zonat



BASHKIA KORÇË

më të frekuentuara të qytetit do të kulmojnë festimet dhe do të tërheqin vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët vijnë në Korçë.

Qëllimi: Promovimi i Korçës dhe zhvillimi i jetës artistike në çelje të sezonit turistik veror, me qëllim tërheqjen e vizitorëve vendas dhe të huaj.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj
- Përfshirja dhe promovimi i bizneseve lokale në festë.
- Rritje të impaktit direkt dhe indirekt në rritjen e të ardhurave të bizneseve të rajonit e më gjerë.

Kostoja Totale: 2,000,000 lekë

Titulli i projektit: ROCK FESTIVAL

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë prej më shumë se 3 vjetësh organizon në qendër të qytetit me grupe motoristësh nga disa vende të rajonit aktivitetin që ofron plot emocione dhe spektakël me muzikë rock. Aktiviteti organizohet me pjesëmarrjen e mbi 500 pjesëmarrësve nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, Greqia, etj, të cilët kanë realizuar aktivitete në vende të ndryshme të Shqipërisë. Organizimi i aktivitetit "Korca Motor Shoë" në bashkëpunim me "Riders Legend".

Këtë vit ndryshe nga edicionet e kaluara synimi është realizimi i një eventi me kohëzgjatje me të madhe, i cili do të realizohet tek Poli i Jugut, qendra e eventeve turistike dhe jetës së natës. Pjesëmarrës do të jenë jo vetëm motoristët e Ride Legend, por edhe Harley Moto Club, Vespa Club dhe makinat Retro, shoqëruar me një festival të mirëfilltë të muzikës rock dhe mundësi camping dhe hiking gjatë ditëve të organizimit të aktivitetit, mundësi që zona t'i ofron për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj. Eventu gjithashtu kënaq shijet e të apasionuarve pas mjeteve motorike, të cilat do të bëjnë parakalime në destinacionet më të bukura të Korçës e do të ekspozohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit.

Qëllimi:

Promovimi i aktiviteteve që lidhen me turizmin e aventurës, promovimi i destinacioneve më të bukura të Korçës si edhe promovimi i muzikës rock të parapëlqyer nga të gjitha grupmoshat.

Objektiva:

- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore të banorëve të Korçës
- Tërheqja e turistëve të huaj për të frekuentuar aktivitete të veçanta
- Promovimi i muzikës së mirëfilltë rock
- Zhvillimi i turizmit të aventurës
- Zhvillimi i ekonomisë lokale

Kostoja Totale: 5,000,000 lekë



BASHKIA KORÇË

Titulli i projektit: FOOD & DRINK FESTIVAL

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë për herë të parë këtë vit do të organizojë një panair të dedikuar industrisë ushqimore dhe pijeve, duke sjellë për vizitorët sipërmarrjet më të rëndësishme të këtij sektori në rajon, si dhe disa shoqëri më të vogla prodhuesish vendas, të cilët përbëjnë një realitet interesant dhe gjithmonë në zhvillim. Ditët e zhvillimit të aktivitetit “Food & Drink Festival” do të shoqërohen me aktivitete të ndryshme si degustime pijesh si edhe produkte tipike të ofruara nga prodhues të talentuar të ushqimeve artizanale, shoë cooking dhe informim rreth risive të industrisë ushqimore. Pjesëmarrës në aktivitet mund të jenë tregëtues të street food, shkolla të gatimit, të rinj të apasionuar dhe të talentuar pas gatimit etj. Eventit përfshin “Festivalin e Ushqimit”, që ka për qëllim promovimin e ushqimeve më të mira që mund të gjenden në restorantet e Korçës, si edhe evente lokale të gatimit korçar (tradita e përgatitjes së lakrorit në saç). Gjatë eventit, ju mund të provoni produktet e shijshme, të degjoni muzikë fantastike live si edhe të shijoni atmosferën e veçantë të aktivitetit që do të ofrojë ushqime të shijshme dhe pije për të gjithë.

Qëllimi:

Promovimi i vlerave tradicionale të artit të gastronomisë dhe pijeve dhe nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve
- Rritja e të ardhurave të bizneseve, përmes promovimit, që lidhen direkt apo indirekt me turizmin.
- Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktivitetit
- Ruajtja e traditës së ushqimeve tradicionale

Kostoja Totale: 1,500,000 lekë

Titulli i Projektit: FESTA E BIRRËS 2024

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Festa e Birrës eventit më i madh turistik veror në Shqipëri i ka dhënë edhe më shumë gjallëri jo vetëm qytetit, por gjithë rajonit duke shtuar vit pas viti numrin e turistëve që e frekuentojnë dhe tashmë prej 17 vjetësh përbën produktin turistik më të suksesshëm në rajon. Kjo traditë vazhdon rrugëtimin e vet me suksese gjithmonë e në rritje. Për arsye të pjesëmarrjes së madhe të njerëzve por edhe përmasave gjithmonë në rritje, edicioni i këtij viti vjen me një risi të madhe. Festa e Birrës për herë të parë këtë vit do të zhvillohet në datat 14-18 Gusht 2024 në kompleksin më të madh të koncerteve dhe jetës së natës në Shqipëri, pjesë e projektit madhor, Poli i Jugut, pranë fshatit Drenovë, që do të jetë zona më e madhe e koncerteve dhe e jetës së natës, eventeve, e padyshim dhe e Festës së Birrës. Do jetë një zonë që do të mbajë mijëra njerëz, do jetë një organizim i një formati tjetër, i cili premtun një tjetër standard përherë në rritje dhe gjithëpërfshirëse.

Vitet e fundit, përveç tërheqjes së vizitorëve vendas, tashmë synimi i festës në bashki është ndërkombëtarizimi i vizitorëve, pra tërheqja e vizitorëve edhe nga vende të tjera të botës. Edicionin e kaluar në Festën e Birrës morën pjesë rreth 10 mijë persona çdo natë, të cilët u argëtuan përgjatë pesë netëve me muzikën e zgjedhur nga këngëtarët më të mirë shqiptarë e të huaj. Festa ka arritur një rritje të madhe nga viti në vit, jo vetëm të numrit të pjesëmarrësve, por edhe parametrave të cilësisë, jo vetëm në mënyrën e shërbimit, por edhe të programit muzikor që shoqëron festën, ku përmendim emrat më të mëdhenj të muzikës greke Keti Garbi dhe Despina Vandi, si edhe grupet më të famshme muzikore No Mercy dhe La Bouche. Përveç tyre kulmuan edhe emra të njohur të muzikës shqiptare, duke e bërë programin muzikor të shkëlqyer.



BASHKIA KORÇË

Qëllimi: Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Shtimi i numrit të bizneseve pjesëmarrëse në festë
- Rritja e cilësisë së show live për 5 netë rradhazi dhe krijimi i një infrastrukture të veçantë për realizimin e festës.
- Rritje të impaktit direkt dhe indirekt në rritjen e të ardhurave të bizneseve të rajonit e më gjerë.

Kostoja Totale: 17,100,000 lekë

Titulli i Projektit: KORÇA ELECTRONIC BEAT

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Për herë të parë në Korçë vjen aktiviteti që ndërthur muzikën me teknologjinë, trendin e kohëve moderne që ka për qëllim promovimin e muzikës elektronike. Në të gjithë botën evente të kësaj natyre janë padyshim një element që tërheq miliona vizitorë të cilët rezevojnë shumë kohë përpara pjesëmarrjen në event. Korça Electronic Beat synon të realizojë një festival të madh të muzikës elektronike, me pjesëmarrjen e DJ më të njohur, i cili përfshin shfaqjet e veçanta me projeksione dhe efekte speciale dritash shumëgjyreshe, fishekzjarre e surpriza të tjera. Eventu synon të ndërthurë elementë të traditës në rrugicat e ballkonet karakteristike të Korçës për ta kulmuar me performancat muzikore më të bukura tekno nga DJ profesionistë. Eventu do të bashkojë interpretues të ndryshëm muzikorë, të cilët do të impresionojnë të gjithë me stilin dhe muzikën e realizuar deri në orët e vona të mbrëmjes.

Qëllimi: Krijimi i një eventu të ri për të apasionuarit dhe fansat e muzikës tekno, e cila rezulton e frekuentuar masivisht nga të gjithë grupmoshat dhe kryesisht të rinj.

Kostoja totale: 1,000,000 lekë

Titulli i projektit: TIME TRAVEL VOSKOPOJA

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Voskopoja, një qendër kulturore dhe historike e rëndësishme e cila është kthyer në destinacionin turistik model në Shqipëri. Këtë vit ndryshe nga vitet e kaluara, Bashkia Korçë ka qëllim për të krijuar një eksperiencë të re, e cila ka për qëllim të rrëfejë virtualisht historinë e Voskopojës e ta rikthejë atë në një formë tepër të veçantë përgjatë gjithë vitit. Promovimi i VR eksperiencë, si edhe program me muzikë live, do të shtojë ofertën turistike të Voskopojës, duke tërhequr akoma më tepër vëmendjen e vizitorëve për ta zbuluar e për t'u njohur me historinë e veçantë të saj.

Qëllimi: Promovimi i historisë së Voskopojës si edhe tërheqja e vëmendjes së vizitorëve të huaj drejt destinacionit turistik të Voskopojës.

Objektiva:

- Promovimi i Voskopojës si destinacion i rëndësishëm turistik
- Përjetimi që të ofron eksperiencë virtuale për të njohur historinë e trashëgiminë e Voskopojës
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.



BASHKIA KORÇË

- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

Kostoja Totale: 500,000 lekë

Titulli i projektit: Christmas & Light Festival

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Korça është qyteti i parë që ideoi Panairin e Fundvitit dhe Festivalin e Dritave, me qëllim krijimin e atmosferës festive jo vetëm për banorët e saj, por edhe për tërheqjen e vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët vijnë për t'u argëtuar dhe për të festuar fundvitin në Korçë. Çdo vit që nga festat e nëntorit e deri ditët e para të janarit hotelet e Korçës janë të rezervuara. Muaji dhjetor rezulton nga të jetë më i frekuentuari, çka do të thotë se të gjitha hotelet dhe bujtinat që operojnë në qytet dhe në fshat janë rezervuar muaj më parë, duke e bërë Korçën destinacionin turistik më të preferuar nga vizitorët vendas dhe të huaj. Larmi aktivitësh do të ketë gjatë gjithë muajit dhjetor. Përmendim Marketin e Bredhave natyralë, i vendosur tek sheshi para Katedrales "Ringjallja e Krishtit", ku të gjithë kanë mundësi të zgjedhin pemën natyrale të Krishtlindjes për të dekoruar dhe për të krijuar atmosferë festive në shtëpitë gjatë festimeve të Krishtlindjes dhe Vitit të Ri. Christmas Market tek sheshi para Kullës Panoramike është vendi fantastik për blerjet tuaja të Krishtlindjes. Të gjithë mund të shijojnë aromën e rakisë së pjekur, gështenjave dhe produkteve lokale në argëtimin pafund që ofron Pista e Patinazhit. Vendi ideal ku të gjithë mund të blejnë dhurata fantastike, për t'i vendosur nën pemën e Krishtlindjes, ose për t'ua dhuruar të afërmeve dhe miqve. Nuk do të mungojnë lojërat dhe aktivitetet argëtuese për fëmijët si edhe spektakli i fishekzjarreve në mbrëmjen e ndërrimit të viteve në qendër të qytetit, i cili nuk duhet humbur. Të gjitha eventet e muajit dhjetor 2024 do të kulmojnë me performancat muzikore live, koncerte nga grupe e banda muzikore si edhe street party me DJ më të njohur në një prej destinacioneve më atraktive dhe turistike siç janë "Pazari i Vjetër" i Korçës dhe Zona Këmbësore, zona tepër të frekuentuara nga vizitorët gjatë periudhës së festave të fundvitit.

Qëllimi: Promovimi i Korçës si kryeqendra e Krishtlindjes dhe e festimeve të fundvitit në Shqipëri, me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e ekonomisë lokale, si dhe tërheqjen e vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët zgjedhin të argëtohen e festojnë në Korçë Krishtlindjen dhe festat e fundvitit përmes eventeve të realizuara nga Bashkia.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Rritja e të ardhurave të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (bare, restorante, etj).
- Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktivitetit
- Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave.
- Promovimi i grupeve muzikore dhe këngëtarëve të talentuar shqiptarë

Kostoja totale: 3,000,000 lekë



BASHKIA KORÇË

Titulli i projektit:

“PJESËMARRJE NË PANAIRE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE”

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Për Bashkinë e Korçës turizmi është një nga prioritetet kryesore zhvillimore, jo vetëm bazuar te resurset natyrore, trashëgiminë e pasur kulturore dhe historike, por edhe tek projektet tona të shumta në këtë drejtim, investime, festa dhe aktivitete të larmishëm përgjatë gjithë vitit për të tërhequr sa më shumë vizitorë vendas dhe të huaj duke e parë këtë potencial si burim për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Gjatë vitit 2024 Bashkia Korçë do të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, që mund të organizohen nga institucione publike dhe private në Shqipëri ose jashtë saj dhe që kanë në fokus promovimin e vlerave turistike të vendeve pjesëmarrëse. Pjesëmarrja e Bashkisë Korçë në aktivitete të tilla, rrit numrin e vizitorëve dhe investitorëve, si edhe krijon kontakte me investitorë të huaj, agjensi turistike me të cilët Bashkia Korçë bashkëpunon në të ardhmen.

Qëllimi: Promovimi i ofertës turistike të rajonit të Korçës, si dhe vendosja e bashkëpunimit me tour operatorët vendas dhe të huaj me qëllim zhvillimin e gjithë rajonit. Rritje të bashkëpunimit me biznese që operojnë në fushën e turizmit (agjensi turistike, tour operatore, stuktura akomoduese), etj.

Objektivat:

1. Zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit publiko-privat, me synim përmirësimin e jetesës së qytetarëve, si dhe nxitjen e investimeve në qytet me fokus turizmin
2. Gjallërimin e bizneseve vendase dhe të huaja.
3. Prezantimin e mundësive dhe ideve për zhvillimin e turizmit në qytetin e Korçës.

Kostoja totale: 500,000 lekë

Shënime: Disa prej panairove kombëtare dhe ndërkombëtare të planifikuara për t'u zhvilluar gjatë vitit 2024, janë Panairi Ndërkombëtar i Turizmit, i cili është planifikuar të zhvillohet në datat 16-17 Prill 2024 në Prishtinë si edhe Panairi Ndërkombëtar i Turizmit, organizuar në datat 14-16 Nëntor 2024 në Selanik, Greqi.

Titulli i projektit: FESTIVALI I SERENATËS

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Festivali i Serenatës vjen për herë të parë këtë vit në formatin e një festivali ndërkombëtar të Serenatës, i cili ka për qëllim të bashkojë vendet që e kanë këtë lloj muzike si Spanja, Italia, Franca, Amerika Latine, etj. Ky event ndërkombëtar nga pikpamja e zhanrit muzikor që përfaqëson përpiqet të promovojë fuqinë e bukurisë e dashurisë përmes këtyre këngëve, diçka për të cilën Korça dallohet dhe ka për qëllim ruajtjen e trashëgimisë së pasur jomateriale. Vokalistët e talentuar kanë mundësi të interpretojnë këngët më të bukura romantike, duke treguar përmes tyre historinë e vendeve që përfaqësojnë. Festivali i Serenatave është jo vetëm një ngjarje që ka të bëjë me njohjen dhe zbulimin e serenatave, por përbën një ngjarje me rëndësi të madhe sa i përket transmetimit të traditës tek brezat e rinj. Korça tashmë është gati që të mirëpresë këtë ngjarje me rëndësi globale, për ta kthyer në një traditë të përvitshme.



BASHKIA KORÇË

Qëllimi: Promovimi i këngëve të serenatës si edhe ndërlydhja e artistëve nga vende të ndryshme të Europës e botës, që frymëzojnë me historinë, bukurinë dhe atmosferën muzikore që përcjellin.

Objektivat:

1. Ruajta e elementëve të trashëgimisë kulturore të pasur dhe shkëmbim kulturor mes shteteve
2. Rritje e zhvillimit ekonomik të Korçës, përmes shtimit të ofertës turistike përmes festivalit ndërkombëtar.
3. Rritja e potencialit turistik të Korçës, e cila të mirëpresë një event të përmasave globale.

Kostoja totale: 1,000,000 lekë

Titulli i projektit: FLY KORÇA

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë në bashkëpunim me grupin e Aeronautikës Shqiptare organizon çdo vit gjatë mujait Dhjetor aktivitetin “Kampionati i Fluturimeve të Lira”. Në malin e Moravës, organizohen fluturime të lira të aeronautistëve nga vende të ndryshme të botës. Për të gjithë të apasionuarit pas sporteve në natyrë, do të zhvillohen fluturime të lira me ndihmën e profesionistëve. Pas përfundimit të garave gjatë aktivitetit, realizohet Ceremonia Zyrtare e ndarjes së çmimeve për fituesit e Kampionatit.

Qëllimi: Promovimi i aktiviteteve sportive të veçanta, për të gjithë të apasionuarit pas sporteve të aventurës në qytetin e Korçës.

Objektiva:

- Promovimi i Korçës nga një tjetër këndvështrim nga sporti i aventurës
- Pjesëmarrja e shteteve të huaja në kampionat
- Pjesë e kalendarit kulturor dhe artistik ku bëhen bashkë me atë sportiv në periudhën me të bukur të festave të fundvitit.
- Synimi është kthimi i këtij aktiviteti në një tradite kulturore
- Promovimi i qytetit në shtete të ndryshme
- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj të apasionuar pas turizimit të aventurës në vitet në vazhdim

Kostoja Totale: 870,000 lekë

Titulli i projektit: MARKETING NË RRJETET SOCIALE NDËRKOMBËTARE

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë, me qëllim promovimin e qytetit të Korçës dhe tërheqjen e vëmendjes së vizitorëve të huaj ndaj këtij destinacioni turistik, ka planifikuar që gjatë vitit 2024 të promovohet në rrjete sociale e platforma ndërkombëtare. Duke marrë parasysh ndikimin e madh që kanë rrjetet sociale në promovimin



BASHKIA KORÇË

e destinacioneve turistike dhe potencialin turistik që destinacionet ofrojnë, e shohim të domosdoshme dhe me vlerë promovimin e Korçës në portale ndërkombëtare të klikuara nga e gjithë bota.

Qëllimi: Promovimi i Korçës në rrjetet sociale dhe portale ndërkombëtare me influencë në tërheqjen e vizitorëve të huaj.

Objektiva:

- Promovimi i Korçës me qëllim tërheqjen e vizitorëve të huaj.
- Rritjen e netëqëndrimeve në Korçë
- Rritjen e vëmendjes ndaj potencialit turistik që Korça ofron

Kostoja Totale: 500,000 Lekë

Në buxhetin e vitit 2024, 2025 dhe 2026 në Bashkinë Korçë do të planifikohet edhe fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës, të cilat do të përdoren si më poshtë:

9.4. Programi AJ122 Fondi rezervë 04910

Për vitin 2024 fondi i planifikuar është në vlerën 10,000 mijë lekë,

Për vitin 2025 fondi i planifikuar është në vlerën 10,000 mijë lekë,

Për vitin 2026 fondi i planifikuar është në vlerën 10,000 mijë lekë,

Fondi rezervë do të përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të paparashikuara, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Buxheti vendor përfshin një fond rezervë, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

9.5. Programi AK122 Fondi i kontigjencës 04940

Për vitin 2024, 2025 dhe 2026 është planifikuar fondi i kontigjencës, në vlerën 10,000 mijë lekë në çdo vit.

Buxheti vendor përfshin një fond kontigjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi i kontigjencës është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. Gjithashtu fondi i kontigjencës krijohet për të përballuar edhe efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.



BASHKIA KORÇË

9.6. Programi Mbrojtja e Mjedisit AD122

9.6.1 Vështrim i përgjithshëm

Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve, si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore

9.6.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve;

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake;

Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;

Pastrimi i rrugëve, parqeve etj.

Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja;

Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes, si dhe masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes;

Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes; Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Administrimi, kordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore;

Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor.

Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

Buxheti i planifikuar për programin mbështetja për zhvillimin ekonomik është 204,089 mijë lekë si më poshtë:

shpenzime personeli	3,970 mijë lekë
shpenzime korrente	190,119 mijë lekë
Shpenzime për investime	10,000 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2024 për këtë program do të jetë në vlerën 3,400 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 570 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë program është në vlerën 153,129 mijë lekë

Fondi i planifikuar për transferta tek organizatat për këtë program është në vlerën 36,989 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për këtë program është në vlerën 10,000 mijë

Produktet e përdorura tek ky program janë:

V510AAA Shërbimi i stafit të menaxhimit të mbetjes dhe pastrimit, këtu përfshihet shërbimi dhe pagesa e



BASHKIA KORÇË

pagave dhe sigurimeve për sektorin e pastrimit të qytetit, NJA; mbledhjen, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve.

V510AAB Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane, këtu përfshihet pagesa për mbetjet e ngurta të mbledhura dhe të transportuara nga zonat urbane drejt vend-depozitimeve në një vit. Këtu përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e blerjes së karburantit për drejtimin e operacioneve të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave një herë në ditë për një distancë mesatare prej XX km në ditë; blerjen, mirëmbajtjen dhe dizifektimin e kontenerëve të mbetjeve; mirëmbajtjen apo ripërtëritjen e mjeteve dhe pajisjeve të transportit apo grumbullimit; etj.

V510AAF Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve, këtu përfshihen pagesat për mbetjet e ngurta nga zonat urbane dhe rurale të depozituara dhe trajtuara në landfill-e nga vetë bashkia apo nga një subjekt i kontraktuar (kundrejt tarifës së depozitimit). Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet përkatëse të trajtimit të mbetjeve në vend-depozitim.

V510AAD Pastrimi i rrugëve dhe parqeve Këtu përfshihen edhe shpenzimet për kriposjen e rrugëve apo pastrimin e tyre nga dëborat gjatë muajve të dimrit. Kjo është sipërfaqja e rrugëve urbane që fshihet/lahet cdo ditë gjatë gjithë vitit. .

V563AAB Subjekte të inspektuara. Ky produkt përfshin aktivitetet dhe kostot që lidhen me inspektimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të subjekteve apo aktiviteteve me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Këtu do të përfshihen si shpenzimet e personelit, ashtu edhe ato të operimit të shërbimit.

V563AAC Promovimi i mbrojtjes së mjedisit. Realizimi I aktiviteteve të ndryshme për sensibilizimin apo impakt të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit.

P532AAA Tek ky produkt janë të planifikuara fondet për investime në programet e mbrojtjes së mjedisit dhe konkretisht Termoizolimi i banesave me bashkëpronësi.

Vlera e planifikuar për shërbimin e pastrimit për vitin 2024 do të jetë në vlerën 152,979 mijë lekë. Kjo vlerë përbëhet nga vlera e kontratës e lidhur gjatë vitit 2023 me 3 vite buxhetore dhe është planifikuar sipas vlerës së llogaritur nga zbatimi i VKM nr. 319 datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.

Shërbimi i pastrimit është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në komunitet. Ky shërbim kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të treta brenda qytetit dhe për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të fshatrave. Objekti i këtij shërbimi është pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe transportimi i tyre për në landfillin rajonal, lagia e rrugëve, evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve, si dhe grumbullimi dhe evadimi i mbetjeve të fshatrave.

Gjithashtu në këtë program për vitin 2024 është përfshirë kontributi i bashkisë Korçë për landfillin e mbetjeve KRWM në vlerën 36,989 mijë lekë.

Tabela e detajuar sipas llogarive ekonomike në këtë program paraqitet si më poshtë:



BASHKIA KORÇË

000/lekë

PBA 2024-2026

(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK

Programi		AD122	Mbrojtja e Mjedisit					
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime		2,237.0	2,499.0	4,289.0	4,535.0	3,970.0	4,773.0	4,821.0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	1,917.0	2,141.0	3,682.0	3,882.0	3,400.0	4,090.0	4,131.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	320.0	358.0	607.0	653.0	570.0	683.0	690.0
Shpenzime Korente të Tjera		132,023.0	114,638.0	157,936.0	157,986.0	190,118.6	191,979.0	192,979.0
Mallra dhe Shërbime	602	82,027.0	74,369.0	120,015.0	120,015.0	153,129.1	152,979.0	152,979.0
Subvencion	603					0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	49,996.0	40,229.0	37,921.0	37,921.0	36,989.5	39,000.0	40,000.0
Transferta të Jashtme	605					0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606		40.0		50.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166					0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651					0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale		0.0	0.0	15,000.0	15,000.0	10,000.0	15,000.0	15,000.0
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	0.0	0.0	15,000.0	15,000.0	10,000.0	15,000.0	15,000.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		134,260.0	117,137.0	177,225.0	177,521.0	204,088.6	211,752.0	212,800.0

Matrica e shpenzimeve operative, produktet dhe matrica e investimeve paraqiten sipas tabelës nr. 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

9.7. Programi: Shërbime Publike Vendore AE122

9.7.1. Vështrim i përgjithshëm

Ky program siguron ofrimin e shërbimeve publike vendore dhe menaxhohet nga Bashkia dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

9.7.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Ky program përfshin funksionin e menaxhimit të rrjetit rrugor rural, menaxhimin e ujitjes dhe kullimit, transportin publik, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit, mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe



BASHKIA KORÇË

korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Buxheti i këtij programi është 693,914 mijë lekë gjithsej dhe fondi që menaxhohet nga Bashkia është në vlerën 116,322 mijë lekë, i detajuar si më poshtë:

shpenzime personeli	1,330 mijë lekë
shpenzime korrente	15,000 mijë lekë
shpenzime për investime	99,992 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2024 për këtë program do të jetë në vlerën 1,140 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 190 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë program është në vlerën 5,000 mijë lekë

Fondi i planifikuar për subvencionin për transportin urban për këtë program është në vlerën 10,000 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për këtë program është në vlerën 99,992 mijë

Produktet e përdorura tek ky program janë:

V626AAB Mirëmbajtja e sipërfaqes së varrezave. Këtu përfshihen mirëmbajtja dhe sistemimi i parcelave të varrezave, rrugëve dhe trotuarëve ndarës; prokurimi i fidanëve; sistemimi i zonave të gjelberta; etj. Sipërfaqe ekzistuese e varrezave të qytetit të mirëmbajtura.

V457AAA Shërbimi i Transportit Publik. Lëvrimi i Shërbimeve të transportit publik dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për punonjësit e mirëmbajtjes së transportit publik; investimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të transportit publik; etj.

V457AAB Subvencionin për shërbimin urban kryhet nga shoqëria “Ortakëria Korca” sh.p.k, e cila subvencionohet duke u bazuar në kontratën e lidhur me këtë shoqëri, e cila përfundon më qershor 2024. Në buxhetin e vitit 2024, ky shërbim planifikohet në vlerën **10,000 mijë lekë**.

P452AAC Fondet e planifikuara për investime përfshihen tek ky produkt.

Tabela e mëposhtme tregon fondet e planifikuara në programin shërbime publike vendore të cilat menaxhohen nga Bashkia dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të detajuara në tabelën nr. 1 Buxheti i bashkisë 2024 dhe njësive shpenzuese pjesë e materialit.



BASHKIA KORÇË

000/lekë

PBA 2024-2026								
(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK								
Programi	AE122	Shërbimet Publike Vendore						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	2021 Fakti	2022 Fakti	2023 Buxheti Fillestar	2023 Buxheti Pritshëm	2024 Plani	2025 Plani	2026 Plani
Paga & Sigurime		192,937.0	202,471.0	252,682.0	269,420.0	293,994.3	282,854.0	285,681.0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	165,327.0	173,485.0	216,666.0	230,798.0	252,009.3	242,382.0	244,803.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	27,610.0	28,986.0	36,016.0	38,622.0	41,985.0	40,472.0	40,878.0
Shpenzime Korente të Tjera		231,493.0	251,285.0	277,674.0	293,771.0	290,222.5	280,666.0	284,380.0
Mallra dhe Shërbime	602	220,673.0	232,931.0	267,674.0	283,022.0	280,222.5	270,666.0	274,380.0
Subvencion	603	9,999.0	9,999.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0
Transferta të Brendshme	604	313.0				0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605					0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	508.0	8,355.0		749.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166					0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651					0.0	0.0	0.0
Rezervat	609					0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale		19,431.0	3,521.0	83,655.0	116,392.0	109,696.9	139,718.0	179,469.0
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	19,431.0	3,521.0	83,655.0	116,392.0	109,696.9	139,718.0	179,469.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		443,861.0	457,277.0	614,011.0	679,583.0	693,913.7	703,238.0	749,530.0

Matrica e shpenzimeve operative me produktet dhe matrica e investimeve do të paraqiten sipas tabelës 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

9.8. Programi: Arsimi Bazë dhe Parashkollor AG122

9.8.1. Vështrim i përgjithshëm

Mbështetja e arsimit bazë dhe parashkollor. Administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

9.8.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës;

Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve;

Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve;

Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.

Buxheti i këtij programi i cili menaxhohet nga Bashkia është në vlerën 50,900 mijë lekë, e planifikuar për shpenzime operative (shpenzime karburanti dhe shpenzime energji, ujë dhe telefon për Shoqërinë e Doktrinës së Krishterë ose shkolla e Maltës) dhe investime dhe konkretisht në arsimin bazë dhe parashkollor:



BASHKIA KORÇË

Shpenzime korrente 900 mijë lekë

Shpenzime për investime 50,000 mijë lekë

Produktet e përdorura tek ky program janë:

V912AAJ Shpenzime për mbështetjen e shkollës Doktrina e Krishterë (shkolla e Maltës)

P912AAA Këtu përfshihen fondet e planifikuara për rikonstruksionet e shkollave të arsimit bazë, parashkollor.

Matrica e shpenzimeve operative me produktet dhe matrica e investimeve do të paraqiten sipas tabelës 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

9.9. Programi: Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm AH122

9.9.1. Vështrim i përgjithshëm

Ky program mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit ka në fokus zhvillimin e projekteve për të rinjtë.

9.9.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore;

Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale;

Shpenzimet për paga për stafin mbështetës.

Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave;

Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve

Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh.

Buxheti i këtij programi, i cili menaxhohet nga Bashkia është në vlerën 10,560 mijë lekë, detajuar si më poshtë:

- Shpenzime korrente 560 mijë lekë

- Shpenzime për investime në vlerën 10,000 mijë lekë

Ky fond është planifikuar për rikonstruksioneve të objekteve të arsimit të mesëm të përgjithshëm.

Produktet e përdorura tek ky program janë:

V923AAH shpenzime për kryerjen e aktiviteteve për të rinjtë

P923AAB rikonstruksion i shkollave arsimit parauniversitar.

Matrica e shpenzimeve operative me produktet dhe matrica e investimeve dotë paraqiten sipas tabelës 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

Shpenzime e planifikuara për realizimin e aktiviteteve për të rinjtë si më poshtë:

Titulli i Projektit: Rrënjët e qytetit tim



BASHKIA KORÇË

Përshkrim i shkurtër i projektit: Në kuadrin e promovimit të vlerave turistike, arkitekturore dhe kulturore të qytetit të Korçës do të organizohet një eskpozitë fotografie ku do të ftohen të rinj të qytetit të Korçës të apasionuar për fotografinë.

Qëllimi: Promovimi i vlerave turistike, arkitekturore dhe kulturore të qytetit të Korçës në syrin rinor

Objektiva:

- Evidentimi i talenteve të të rinjve në fushën e fotografisë
- Promovimi i vlerave turistike, kulturore dhe arkitekturore të qytetit

Kostoja Totale: 190.000 Lekë

Titulli i Projektit: Panairi i Rinisë

Përshkrim i shkurtër i projektit: Bashkia Korçë do të organizojë gjatë vitit 2024, aktivitetin “Panairi i Rinisë”, i cili ka për qëllim promovimin e talenteve të të rinjve në fusha të ndryshme si art, pikturë, muzikë, letërsi, koreografi etj. Qëllimi është sensibilizimi i të rinjve të tjerë të qytetit të Korçës dhe më gjerë se kur ekziston talenti dhe dëshira, realizohen iniciativa të suksesshme jo vetëm individuale, por me impakt për gjithë komunitetin. Aktiviteti do të organizohet me mbështetjen e nxënësve të shkollave të Bashkisë Korçë si edhe organizata rinore të interesuara për të marrë pjesë në panair.

Qëllimi: Promovimi i talenteve të reja të të rinjve në fusha të ndryshme (letërsi, kulturë, shkencë, art, etj).

Objektiva:

- Aktivizimi i të rinjve dhe rritja e interesit për të shpalosur aftësitë e tyre
- Krijimi i mundësive për t’u promovuar përmes aftësive dhe talenteve të tyre në tregun e punës.
- Krijimi i mundësive dhe iniciativave të të rinjve për t’u vetëpunësuar.

Kostoja Totale: 190.000 Lekë

Titulli i Projektit: 9 Maj, Dita e Europës

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Në kuadrin e ditës së Evropës, e cila celebron në çdo datë 9 Maj, me nxënës të shkollave publike do të organizohet një aktivitet sensibilizues me materiale të përzgjedhura nga vetë nxënësit për të treguar mënyrën e krijimit, arsyet, zhvillimin dhe ecurinë e Bashkimit Evropian. Ky aktivitet do të zhvillohet në një ambjent ku mund të jenë të pranishëm të gjithë të interesuarit. Mënyra e krijimit, arsyet, zhvillimin dhe ecuria e Bashkimit Evropian do të sillen në këtë aktivitet nëpërmjet krijimeve dhe materialeve të sjella nga vetë nxënësit. Në këtë kuadër, për realizimin e aktivitetit do të realizohet një dekor tek ambjenti ku do të zhvillohet aktiviteti dhe përreth, me qëllim krijimin e një atmosfere festive.

Gjithashtu organizimi i aktivitetit për ditën e Evropës do të bazohet edhe në tematika vjetore që nxjerr Bashkimi Evropian.

Qëllimi: Organizimi i një aktiviteti sensibilizues për të ndërgjegjësuar brezin e ri me aktivitet me fokus Bashkimin Evropian.

Objektiva:

- Pjesëmarrje aktive në aktivitete që lidhen me Bashkimin Evropian
- Ndërgjegjësim i tyre si qytetarë të ardhshëm të Bashkimit Evropian

Kostoja Totale: 180.000 Lekë



BASHKIA KORÇË

9.10. Programi: Përkujdesi social AI122

9.10.1. Vështrim i përgjithshëm

Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktime të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhes pranë njërive vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta. Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.

9.10.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

- Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari;
- Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare;
- Ndihmë financiare, asistencë për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës;
- Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.);
- Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta;
- Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore;
- Shpenzimet për mbulimin e shërbimit të çerdheve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktime të dhunës kriminale etj.);
- Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira;
- Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj;
- Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.);
- Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor;
- Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambjente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim



BASHKIA KORÇË

profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit; Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore.

- Administrimi dhe mirëmbajtja e qendrave rezidenciale për të moshuarit;
- Përfitime në para dhe në shërbime kundrejt rreziqeve të lidhura me moshën e tretë (humbje e të ardhurave, mungesë pavarësie në kryerjen e detyrave të përditshme, pjesëmarrje e ulur në jetën shoqërore dhe komunitare etj.);
Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore
- Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm;
- Pagesa për grupe pjesë në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, kompensime për humbje të punës, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë;
- Akomodim, ushqim ose veshje dhënë personave të papunë dhe familjeve të tyre;
- Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit;
- Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë;
- Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit;
- Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;

Buxheti i këtij programi, i cili menaxhohet nga Bashkia për vitin 2024 është në vlerën 60,512 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli	37,136 mijë lekë
- shpenzime korrente	13,276 mijë lekë
- shpenzime për investime	10,100 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2024 për këtë program do të jetë në vlerën 31,756 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 5,380 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë program është në vlerën 9,994 mijë lekë

Fondi i planifikuar për subvencionin për interesat e kredise për këtë program është në vlerën 1,342 mijë lekë

Fondi i planifikuar për transferta tek individët në vlerën 1,940 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për këtë program është në vlerën 10,100 mijë

Disa prej produkteve në këtë program janë:

V014AAA Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social. Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e kujdesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara nën administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore.

V014AAB Persona që përfitojnë kujdesin social. Shpenzimet që lidhen me qendrat ditore të kujdesit social për



BASHKIA KORÇË

personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe kostot e tjera të funksionimit të këtyre qendrave përfshihen në këtë produkt. Përfshirë këtu treguesit e grave, të moshuarve dhe femijëve të asistuar me shërbim social.

V014AAD Shpenzime korrente për Qendrën e Kujdesit Paliativ Mary Potter

V043AAA Shërbimi i stafit të Kujdesit për Fëmijët dhe Familjet. Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në kujdesin social të familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

V043AAB Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social. Shpenzimet buxhetore për mbulimin e fëmijëve që përfitojnë shërbimet të caktuara nga qendrat e shërbimit social apo shtëpitë e foshnjës në administrimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore. Referuar numrit të fëmijëve që përfitojnë shërbim pranë këtyre funksioneve do të përlllogariten shpenzimet e planifikuara për realizimin e këtij produkti.

V043AAD Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE. Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore në buxhetin e tyre për mbështetjen e familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skemat e Ndhmës Ekonomike.

V066AAA Shërbimi i stafit të strehimit social. Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e strehimit social.

Totali i buxhetit për programin përkujdesi social do të jetë 66,767 mijë lekë, ku përfshihen shpenzime të cilat menaxhohen nga Bashkia në vlerën 60,512 mijë lekë dhe pjesa tjetër do të menaxhohet nga Qendra Ditore e Zhvillit, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit dhe Shtëpia e Foshnjës.

000/lekë

PBA 2024-2026								
(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK								
Programi	AI122	Përkujdesi Social						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime		19,583.0	23,644.0	37,116.0	37,804.0	41,840.7	36,297.0	36,660.0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	16,781.0	20,275.0	31,752.0	32,394.0	35,787.1	31,103.0	31,414.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	2,802.0	3,369.0	5,364.0	5,410.0	6,053.6	5,194.0	5,246.0
Shpenzime Korente të Tjera		7,848.0	11,954.0	18,699.0	20,990.0	14,825.8	20,031.0	20,140.0
Mallra dhe Shërbime	602	6,022.0	7,013.0	11,730.0	14,003.0	11,543.8	17,731.0	17,840.0
Subvencion	603			1,259.0	1,106.0	1,342.0	1,300.0	1,300.0
Transferta të Brendshme	604	317.0	3,000.0	4,000.0	4,000.0	0.0	1,000.0	1,000.0
Transferta të Jashtme	605					0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	1,509.0	1,941.0	1,710.0	1,881.0	1,940.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale		4,459.0	4,255.0	15,180.0	15,627.0	10,100.0	15,000.0	15,000.0
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	4,459.0	4,255.0	15,180.0	15,627.0	10,100.0	15,000.0	15,000.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		31,890.0	39,853.0	70,995.0	74,421.0	66,766.5	71,328.0	71,800.0



BASHKIA KORÇË

Matrica e shpenzimeve operative me produktet dhe matrica e investimeve do të paraqiten sipas tabelës 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

Projektet e planifikuara në këtë program paraqiten si më poshtë:

Titulli i Projektit: Aktivitet promovues në Kopshtet Komunitare

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Kopshtet Komunitare nuk janë vetëm një atraksion i shtuar në Korçë, por tashmë përfaqësojnë prej 3 vitesh një model të shkëlqyer të punës vullnetare dhe bashkëpunimit komunitar, me synimin për t'u shtrirë edhe më gjerë në hapësira të tjera. Në vitin e parë të krijimit të Kopshteve Komunitare (viti 2020), janë angazhuar vullnetarisht 24 familje të cilat kanë realizuar kultivimin e frutave dhe perimeve në parcelat e Kopshteve Komunitare. Familjet së bashku me fëmijët e tyre kujdesen çdo ditë me shumë përkushtim gjatë gjithë kohës për punimin, plehrimin e tokës, mbjelljen, ujitjen e tokës, si edhe promovimin dhe vjeljen e prodhimeve.

Gjatë sezonit të vjeshtës, janë organizuar aktivitete për promovimin e prodhimeve të marra nga parcelat e kopshteve dhe të gjitha produktet e përfituara nga kopshtet, janë dhuruar në menecat sociale, që ju shërbejnë njerëzve në nevojë.

Në vitin 2024 përmes aktiviteteve me Kopshteve Komunitare synohet gjithëpërfshirje më qëllim zgjerimin e komunitetit dhe ndërveprim komunitare, si psh mbjellja e pemëve në ditën e tokës në kodrat e qytetit, si dhe inisiativa për mbrojtjen e mjedisit. Event në ditën botërore të familjes, si njësi bazë e shoqërisë dhe promovimi i familjes kujdestare.

Qëllimi: Promovimi i iniciativave vullnetare për t'u marrë me kopshtari, me qëllim përfshirjen e sa më shumë njerëzve në aktivitete të bujqësisë urbane, e cila është jo vetëm argëtuese, por edhe tepër e dobishme për të edukuar dhe nxitur tek brezat e rinj ushqyerjen e shëndetshme, si edhe zhvillimin e frymës komunitare. Ndërgjegjësimi për kujdesin ndaj mjedisit, gjithëpërfshirjes dhe promovimin e rëndësisë së familjes dhe marrëdhënies prind fëmijë.

Objektiva:

- Nxitja e iniciativave të bashkëpunimit social në komunitet.
- Ritja e angazhimit vullnetar të familjeve dhe edukimi i vullnetarizmit tek brezat e rinj.
- Përvetësim me informacion dhe praktika të vazhdueshme për kujdesin ndaj mjedisit për fëmijët dhe familjet.
- Motivimi i grupeve vullnetare për angazhim të qëndrueshëm.
- Nxitja drejt të ushqyerit shëndetshëm.
- Rëndësia e familjes dhe promovimi i familjes kujdestare.

Kostoja totale: 381,500 Lekë

Titulli i projektit: Dita Ndërkombëtare e Gruas

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Dita Ndërkombëtare e gruas 8 Mars, njihet në të gjithë botën si dita për të ndihmuar në krijimin e një bote më të mirë, më gjithëpërfshirëse për gratë, pa paragjykime, stereotipa dhe diskriminim. Një botë që është e larmishme, e barabartë dhe gjithëpërfshirëse. Një botë ku ndryshimi vlerësohet dhe festohet. Për të festuar arritjet e grave në çdo fushë, Bashkia ka menduar t'ju dhurojë grave në shenjë mirënjohje lule së bashku me thënie frymëzuese.

Qëllimi:

Sensibilizimi qytetar për respektimin e të drejtave të vajzave dhe grave, për një botë më gjithëpërfshirëse



BASHKIA KORÇË

për gratë arritjet e tyre.

Objektiva:

Vlerësimi i rolit të gruas në jetën e fëmijëve dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Solidarizim dhe sensibilizim për barazi gjinore

Vlerësim i përpjekjeve dhe arritjeve të grave në shoqëri.

Kostoja totale: 400,000 Lekë

Nr.	Titulli i projektit: Strehëzë emergjente për viktimat e dhunës në familje .	Programi: Përkujdesi Social Funksioni: Krijimi i një ambienti familjar dhe te sigurt për viktimat e dhunës në familje.
------------	--	---

a) Pershkrimi i shkurtër i projektit.

i. Situata.

Marrja me qera e një apartamenti, pagesa e ujit dhe energjisë elektrike. Ky apartament shërben si strehëz për rastet emergjente të dhunës në familje. Në bashkëpunim me partnerët bëhet plotësimi i nevojave të tyre në veshmbathje dhe ushqim dhe shërbim psiko-social.

ii. Synimi i nismës/projektit

Krijimi i një ambienti familjar dhe të sigurt për viktimat e dhunës në familje në momentin emergjent që paraqitet.

1. Marrja me qera e një apartamenti që do të shërbejë si strehëz emergjente.
2. Akomodimi i personave të dhunuar deri në kalim e emergjencës që paraqet rasti.
3. Sigurimi i shërbimeve të tjera të nevojshme që do të mundësohen nga një organizatë jo qeveritare.

Shpenzimet e llogaritura

Buxheti i parashikuar	Aktivitetet e organizuara	Përshkrimi	Kohëzgjatja	Sasia	Kostot muaj/njësi	Kontribut Bashkia Korçë
		Qera (apartament)	12 muaj	1	9,000	108,000
		Pagesa uji (faturë/muaj)	12 muaj	1	6,000	72,000
		Pagesë energjie elektrike(faturë/muaj)	12 muaj	1	6,000	72,000
		Total				252,000



RASHKLA KOSOGË

Nr.	Titulli i projektit : 24 Qershor “Dita e Egjiptianëve të Ballkanit”	Programi: Përkujdesi Social Funksioni :Zhvillimi i një takimi ku do të marrin pjesë përfaqësues nga institucionet, përfaqësues nga organizatat egjiptiane dhe romë, por edhe persona nga komuniteti egjiptian dhe rom, për të diskutuar rreth problematikave që përballet komuniteti në Qytetin tonë .
-----	---	--

a) Përshkrimi i shkurtër i nismës	
i. Situata	
<p>24 Qershori Dita e Egjiptianëve të Ballkanit është një festë e cila na sjell në vëmendje komunitetin egjiptian , nje komunitet i cili është i përhapur gjërësisht, por mund të themi që janë integruar shumë në shoqëri por ka ende problematika të ndryshme, ku mund të përmëndim papunesine , arsimimin, strehimin shëndetësin etj. Ajo që është e rëndësishme të kujtohet në këtë ditë është pikërisht se si mund ti vijme ne si shoqëri, si bashkëjetues në ndihmë këtij komuniteti me vështirësit që ata hasin në përditshmëri.</p> <p>Gjatë këtij takimi përfaqësuesit nga komuniteti do të kenë mundësinë të bëjnë pyetje të drejtpërdrejta dhe të bashkëbisedojne me përfaqësuesit e institucioneve rreth problemeve të cilat mund të kenë zgjidhje, por ju mungon informacioni ,por gjithashtu mund të prezantohen edhe me planet, masat dhe politikat për të përmirësuar situatën aktuale të komunitetit egjiptian.</p>	
ii. Synimi i nismës/projektit	
Synimi i aktivitetit është diskutimi i problematikave dhe mënyrave se si mund te zgjidhen , por edhe marrja e informacioneve që ju mungon në lidhje me ofrimin e shërbimeve.	

Shpenzimet e llogaritura						
1.Materiale promocionale	Aktivitetet e organizuara	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
				Fletëpalosje dyfletëshe	copë	50
		Spila me logo	copë	30	200	6000
		Stilolapsa me logo	copë	30	200	6000
		Canta beze me logon e festës	copë	30	700	21,000
		Rroll up baner me mekanizëm	copë	1	20,000	20,000
		Total				56,000



BASHKIA KORÇË

Nr.	Titulli i projektit : 8 Prilli “Dita Ndërkombëtare e komunitetit Rom”	Programi: Përkujdesi Social Funksioni: Dita Ndërkombëtare e romëve është një festë që njihet gjëresisht dhe në këtë ditë do të promovohet kultura dhe tradita e komunitetit rom në një nga shkollat 9-vjeçare të Qytetit.
------------	--	---

a) Përshkrimi i shkurtër i nismës
i. Situata
8 Prilli Dita Ndërkombëtare e Romëve është një festë e njohur në të gjithë botën .Në këtë ditë sillen ne vemendje tradita ,kultura e komunitetit por edhe problematikat që hasin në përditshmëri në Shqipëri konkretisht në qytetin e Korçës. Disa nga problematikat kryesore janë: papunësia mungesa e strehimit , diskriminimi për shkak të ngjyrës etj .Në këte ditë mesazhi që duam të përcjellim është stop diskriminimit më pak përbuzje më shume mbështetje dhe paqe me njëri tjetrin .Të rrinjtë janë ata ate cilët duhet të bëjnë ndryshimin për të zbehur fenomenet e sipërpërmendura .Qellimi i aktivitetit është njohja me historikun e komunitetit Rom nga nxënësit e një prej shkollave 9-vjeçare të qytetit dhe percjellja e mesazheve “ Stop diskriminimit”nga vetë fëmijët .
ii. Synimi i nismës/projektit
Synimi i aktiviteve që do të organizohet është përcjellja e mesazheve sensibilizuese nëpërmjet aktiviteve.Aktiviteti ka për qëllim njohjen e nxënësve të një prej shkollave 9 -vjeçare me historikun e komunitetit Rom dhënia e mesazheve sensibilizuese nga fëmijet të cilat do të kenë tematikë, kultura dhe tradita rome, ku secili prej tyre mund ti percjell në mënyra të ndryshme nëpërmjet pikturës ,lojrave etj. Në këtë projekt do të marrin pjesë rreth 30 nxënës nga një prej shkollave 9 -vjeçare të qytetit.

Aktivitetet	Operative			Burimi i financimit(Leke)			
	Paga	Sigurime	Operative	Transferti	Tarifat	Donator	Bashkia
1.1 Zhvillimi i aktivitetit							
1.2 Njohja e kulturës dhe historisë së komunitetit rom nga të rinjtë dhe dhënia e mesazheve							

**BASHKIA KORÇË**

sensibilizuese.			25,200			25,200
1.Fëmijët do të veshin bluzat e pambukut të stampuara me flamurin e komunitetit rom dhe do të lëshojnë tullumbacet me ngjyrat e flamurit rom.			6,000			6,000
2.Shpërndarja e fletpalosjeve			20,000			20,000
3.Vendosja e banerit në ambientin ku do të zhvillohet aktiviteti.						
4.Shfaqja e një historiku të shkurtër të komunitetit rom në video projektor			24,000			24,000
5.Zhvillimi i një cateringu në ambientet e shkollës.						
Shuma (lekë)			75,200			75,200

Nr.	Titulli i projektit: Ndërgjegjësimi i institucioneve publike dhe private për Barazinë Gjinore.	Programi: Përkujdesi Social Funksioni : Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i institucioneve për trajtim dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe ndihmë në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës pa dallim për shkak të gjinisë, fesë, moshës, racës,etj.
a) Përshkrimi i shkurtër i nismës		
i. Situata		
Prej vitesh në Bashkinë Korçë një punonjës ka trajtuar çështjet e Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore. Aktualisht Bashkia Korçë ka vënë në funksion zyrën e Barazisë gjinore duke emëruar Specialist për trajtim vetëm të çështjeve gjinore. Një aspekt shumë i rëndësishëm është promovimi i të drejtës për barazi të grave dhe burrave, të reja dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, si parakusht themelor për demokracinë dhe shoqërinë demokratike. Nga feedback- u i marrë në takimet e realizuara nga specialistët e Drejtorisë së Kujdesit Social rezulton se është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit gjinor në zonat urbane dhe rurale të Bashkisë Korçë.		
ii. Synimi i nismes/projektit		
Ndërgjegjësimi i institucioneve publike dhe private për Barazinë Gjinore. Ndërmjet këtij projekti synohet rritja e ndërgjegjësimit për pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe		



BASHKIA KORÇË

meshkujve, grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës, në pozita të barabarta ndërmjet tyre pa diskriminuar për shkak të fesë, moshës, racës, gjinisë.

Shpenzimet e llogaritura

Materiale promocionale	Aktivitetet e organizuara	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
		Rroll up baner me mekanizëm	copë	1	12,000	12,000
		Fletëpalosje	copë	400	80	32,000
		Stilolapsa me logo	copë	50	150	7,500
		Spila me logo	copë	50	150	7,500
		Bluza të stampuara	copë	20	1200	24,000
		Total				83,000

Nr.	Titulli i projektit: Qendra ditore për fëmijë – Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë	Programi :Përkujdesi Social Funksioni: Të përmirësojë mirëqenien e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian përmes integritit social dhe reduktimit të varfërisë.
------------	---	--

a) Përshkrimi i shkurtër i nismës

i. Situata

Bashkia në bashkëpunim me organizata që operojnë në vend, do të vazhdojnë implementimin e këtij projekti për të shmangur efektet e izolimit social dhe problematikat e ndryshme me të cilat përballet komuniteti Rom dhe Egjiptian në qytetin e Korçës. Kjo sugjeron një vazhdimësi në financim të këtyre qendrave komunitare dhe mbështetjen e tyre të mëtejshme.

ii. Synimi i nismës/projektit

Të përmirësojë mirëqenien e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian përmes integritit social dhe reduktimit të varfërisë. Rritja e aftësive konjitive dhe psiko-sociale të fëmijëve.

Aktivitetet	Operative			Burimi i financimit(Leke)		Totali
	Paga	Sigurime	Operative	Donator	Bashkia	
Kosto stafi			3,646,008	3,646,008		3,646,008
Kosto direkte te projektit				3,533,664	1,770,000	5,303,664
Qera			1,320,000		1,320,000	
Pagesa e energjisë elektrike dhe ujë			450,000		450,000	
Të tjera				3,533,664		
Kosto administrative			446,092	446,092		446,092
Shuma (Leke)						



BASHKIA KORÇË

				7,625,764	1,770,000	9,395,764
TOTALI I KOSTOS SE PROJEKTIT NE LEK				9,395,764		

Nr.	Titulli i Nismës: Qendër Komunitare për moshën e tretë.	Programi: Përkujdesi Social Funksioni: Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve të ndryshme
a) Përshkrimi i shkurtër i nismës		
i. Situata		
Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre. Janë 4 qendra për moshën e tretë të shpërndara në vende të ndryshme të qytetit me qëllim gjithëpërfshirjen.		
ii. Synimi i nismës/projektit		
Ofrimi i një mjedisi çlodhës dhe mikëpritës për të moshuarit. Ofrimi i shërbimeve të specializuara sociale nëpërmjet 4 kujdestarëve të qendrave, punonjësit sociale dhe atij animator. Organizimi i aktiviteteve social-kulturore, argëtuese Përmirësimi i kushteve shëndetsore të frekuentuesve të Qëndrave. Ofrimi i shërbimeve të tjera të nevojshme për të moshuarit. Numri i të moshuarve përfitues (200 të moshuar) Në këto qendra nuk ka një kriter për tu pranuar, çdo i moshuar mund të shkojë. Në këto qendra ka më shumë përfitues të gjinisë mashkullore.		

Shpenzimet e llogaritura.									
Materiale	Aktivitetet e organizuara	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Kosto lek/Njesi	Total	Kostot e projektit	Fond Bashkia	Fond Donator
		1.Kosto stafi							
		1.1. Menaxher projekti	1	person	27,148	11	298,628		298,628
		1.2. Punonjes Social	4	person	166,890	11	1,835,790		1,835,790

**BASHKIA KORÇË**

	1.3. Sanitare	1	person	39,678	11	436,458		436,458
	2. Kosto direkte të projektit							
	2.1 Shërbime ditore	4	qender	28,000	11	308,000		308,000
	2.2 Aktivitete Sociale	4	qender	15,000	4	60,000		60,000
	2.3 Kamponati i 4lojrave (domino)	4	qender	3,000	4	12,000		12,000
	2.4 Mirëmbajtje e qendrave	4	qender	3,225	5	16,125		16,125
	2.5 Qera (4 qendra)	4	qendra	36,000	12	1,728,000	1,728,000	
	2.6 Energji & ujë	4	qendra	22,500	12	1,080,000	1,080,000	
	3.Kosto administrative							
	3.1 Kosto administrative	4	qendra	3,000	11	33,000		33,000
						5,808,000	2,808,000	3,000,000



BASHKIA KORÇË

Nr.	Titulli i Projektit: “Fond Social për rastet emergjente”	Programi: Përkujdesi Social Funksioni: Ofrimi i nevojave bazike për kapërcimin situatës së vështirë ekonomike.
------------	---	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit.

i. Situata.

Nevoja për mbështetje emergjente me paketa ushqimore për rastet në menaxhim.

Plotësimi i nevojave bazike për rastet që vlerësohen në situatë shumë të vështirë ekonomike dhe sociale.

Këto paketa ushqimore do të përfitohen nga persona të cilët në momentin e vlerësimit nuk kanë asnjë mundësi ekonomike për plotësim nevojash bazike.

ii. Synimi i nismës/projektit

Plotësimi i nevojave emergjente për kapërcimin e situatës së vështirë social-ekonomike të rasteve në menaxhim.

Shpenzimet e llogaritura

Buxheti i parashikuar (të tjera)	Aktivitetet e organizuar	Përshkrimi	Kohëzgjatja	Sasia	Njësia	Çmimi	Kontribut Bashkia Korçë
		Paketë ushqimore	12 muaj	20	pako	5000	100,000
		Paketë Higjieno-Sanitare	12 muaj	10	pako	5000	50,000
		Total					150,000

Nr.1	Titulli i Nismës: Dita Botërore e Autizmit	Programi : Përkujdesi Social Funksioni : Informimi i qytetarëve për identifikimin në moshë të hershme
-------------	---	--

a) Përshkrimi i shkurtër i nismës

i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative/pozitive, përfshi të dhëna për zonën)



BASHKIA KORÇË

Autizmi është një çrregullim i zhvillimit, i karakterizuar nga dëmtimi i ndërveprimit social dhe komunikimit, si dhe nga sjellje të kufizuara dhe përsëritëse. Këto shenja në shumicën e rasteve fillojnë përpara se fëmija të bëhet tre vjeç. Shumë prindër për shkak të stigmës dhe mungesës të informacionit neglizhojnë shenjat e para.

Nga statistikat e fundit në botë në vitin 2020 kemi një rritje të probabilitetit për persona me autizëm nga 1 në 68 persona shfaqnin shenja të ÇSA ka qenë në vitin 2015 tashmë probabiliteti është rritur në 1 në 48 persona që shfaqin shenja të ÇSA. Kjo shifër pritet të rritet prandaj edhe ndërgjegjësimi dhe pranimi nga shoqëria bën diferencën në komunitet dhe më gjerë.

ii. Synimi i nismës/projektit (çfarë do të zgjidhni për atë që është problem kryesor, përfitimi i grupit të synuar)

Dita botërore e Autizmit synon të rrisë ndërgjegjësimin lidhur me çrregullimin e spektrit të autizmit dhe përmirësimin e jetës të atyre që jetojnë me autizëm.

Shumë prindër për shkak të stigmës dhe mungesës të informacionit neglizhojnë shenjat e para. Nuk e pranojnë problemin ose nuk kanë informacion ku të drejtohen.

Përfshirja e nxënësve të shkollave të ndryshme të qytetit ka si qëllim sensibilizimin e adoleshentëve për pranimin në komunitet dhe në rrethin shoqëror. Ndryshimi fillon nga brezat e rinj dhe rritja e gjithëpërfshirjes në arsim vitet e fundit sjell dhe nevojën për pranim më të gjërë në shoqëri.

Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm)

Materiale	Aktivitetet e organizuara	Materiale promovionale				
		Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
		Fletëpalosje informuese "Autizmi"	copë	200	35	7,000
		Stilolapsa me logo	copë	100	100	10,000
						17,000
		Materiale të tjera				
		Tullumbace me helium (ngjyrë e kaltër/ bojëqielli)	copë	50	300	15,000
						15,000
		Total:				32,000 Lekë



BASHKIA KORÇË

Nr.	Titulli i projektit: Ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje.	Programi: Përkujdesi Social Funksioni : Sensibilizimi i komunitetit mbi fenomenin e dhunës në familje. Ndërgjegjësimi sa më i efekshëm do të kërkojë një komunitet më të vetëdijshëm për çështjen e adresimit të dhunës ndaj grave, një rol më aktiv të shoqërisë civile dhe një koordinim më të mirë të aktorëve përgjegjës në nivel lokal.
------------	--	--

a) Përshkrimi i shkurtër i nismës

i. Situata

Një aspekt shumë i rëndësishëm në luftimin e dhunës në familje është sensibilizimi ndaj fenomenit dhe aspekteve negative të tij. Nga statistikat rezulton që komuniteti, kryesisht gra dhe vajza, ndonëse të dhunuara, nuk raportojnë për dhunën e ushtruar. Ndërgjegjësimi dhe informimi nëpër shkolla si dhe takime informuese me gra dhe vajza është mjaft i rëndësishëm në mënyrë që të rritet denoncimi ndaj krimit të dhunës në familje në këto zona.

ii. Synimi i nismës/projektit

Sensibilizimi i komunitetit mbi fenomenin e dhunës në familje.

Synimi është sensibilizimi i të gjithë komunitetit pa dallim feje, moshe, race ,gjinie në mënyrë që informimi të bëhet për të gjithë , të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe informimi të jetë sa më i lartë.Të gjithë ata persona të cilët kanë rënë pre e dhunës në familje, të jenë të informuar dhe të dinë ku të drejtohen në rast se hasin ose bien pre e një rasti dhune.

d) Shpenzimet e llogaritura

Materiale promocionale	Aktivitetet e organizuara	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
		Rroll up baner me mekanizem	copë	1	20,000	20,000
		Fletëpalosje	copë	400	70	28,000
		Spila me logo	copë	150	200	30,000
		Stilolapsa me logo	copë	150	120	18,000
		Bluza të stampuara	copë	50	1100	55,000



BASHKIA KORÇË

		Canta beze me logon e aktivitetit	copë	50	600	30,000
		Kapele	copë	20	500	10,000
		Total				191,000

10. BUXHETI PËR INSTITUCIONET E VARËSISË PËR VITET 2024, 2025 DHE 2026

10.1.Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

Programi: Shërbime Publike Vendore AE122

Ky program përfshin funksionin e menaxhimit të rrjetit rrugor rural, menaxhimin e ujitjes dhe kullimit, ndërtimin, rehabilitimin e lulishteve, parqeve etj., mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësitë e njësisë të vetëqeverisjes vendore, planifikimin e përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin. Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësor që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.

Buxheti për këtë program për vitin 2024 është 577,592 mijë lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit 2023 ka një rritje prej 39,247 mijë lekë ose 7% më shumë dhe me planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një rritje prej 18,794 mijë lekë ose 3% e detajuar si më poshtë:

Shpenzime për personelin 292,664 mijë lekë

Shpenzime korrente 275,223 mijë lekë

Shpenzime për investime 9,705 mijë lekë

Total 577,592 mijë lekë

Shpenzimet për personelin (600+601) për vitin 2024, duke përfshirë të gjitha funksionet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike do të jenë në vlerën 292,664 mijë lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit 2023 ka një rritje prej 41,148 mijë lekë ose 16% dhe krahasuar me planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një rritje prej 24,528 mijë lekë ose 9%. Kjo rritje vjen si rezultat i zbatimit të VKM nr 326 datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, kategoritë e pagave nga klasa I deri XIII pësuan ndryshime, VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV”, si dhe VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

Shpenzimet korrente (602) për vitin 2024, duke përfshirë të gjitha funksionet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike do të jenë në vlerën 275,223 mijë lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit 2023



BASHKIA KORÇË

ka një rritje prej 12,049 mijë lekë ose 5% dhe krahasuar me planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një rritje prej 10,016 mijë lekësh ose 4%.

Shpenzimet për investime (231) për vitin 2024, duke përfshirë të gjitha funksionet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike do të jetë në vlerën 9,705 mijë, lekë krahasuar me planin fillestar të vitit 2023 ka një ulje prej 13,950 mijë lekë dhe krahasuar me planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një ulje prej 15,750 mijë lekë.

Detajimi i buxhetit sipas funksioneve

		000/lekë
Menaxhimi i Infrastrukturës i Ujitjes dhe Kullimit	04240	51,897
Rrjeti Rrugor Rural	04520	8,094
Shërbime Publike Vendore	06260	446,976
Ndriçim Rrugësh	06440	70,625
Total NSHP		577,592

Që prej vitit 2016 ky Institucion menaxhon edhe funksionet e transferuara të menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe rrjetin rrugor rural. Burimet e financimit të këtyre funksioneve janë nga transferta e pakushtëzuar sektoriale.

Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 15,404 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 2,572 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë në vlerën 33,921 mijë lekë.

Këto shpenzime lidhen me produktet si më poshtë:

V424AAB **Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese.** Këtu përfshihen shpenzimet e personelit për ofrimin rutinë të shërbimit të menaxhimit të ujitjes dhe kullimit, energji elektrike, kancelari, mjete dhe pajisje, materiale ndërtimi, etj. Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitës dhe kanaleve kulluese nëpërmjet pastrimit, sistemimeve, mirëmbajtjeve, meremetimeve apo zëvendësimit të tonbinove, etj.

Rrjeti Rrugor Rural

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 5,935 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 991 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë në vlerën 1,167 mijë lekë.

Këto shpenzime lidhen me produktet si më poshtë:

V452AAA **Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural.** Këtu përfshihen shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Rrugëve Rurale



BASHKIA KORÇË

V452AAB **Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur** Mirëmbajtje rutinë dhe periodike e infrastrukturës rrugore rurale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi I gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve dhe i procedurave të prokurimit për ndërhyrje në mirëmbajtjen e rrugëve; sigurimi i mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me cakull, beton ose asfalt; etj.

Sherbime Publike Vendore

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 221,050 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 36,815 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë në vlerën 180,205 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për investime në vlerën 8,905 mijë lekë.

Këto shpenzime lidhen me produktet si më poshtë:

V626AAA Shërbimi i stafit të ndërmarrjeve publike të gjelbërimit, varrezave. Këtu përfshihen shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sektorët e mirëmbajtjes, gjelbërimit, menaxhimit të varrezave, dekorit të qytetit.

V626AAC Rrugë urbane e mirëmbajtur dhe rehabilituar. Këtu përfshihen shpenzimet e planifikuara për rrugë urbane të mirëmbajtura në qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, rregullimin e sinjalistikës; etj.

V626AAD Sipërfaqet e gjelbra e mirëmbajtur dhe rehabilituar. Mbjellje, shërbim, dhe mirëmbajtja e pemëve dekorative dhe shkurre me gjelbërim të përhershëm, shërbim bari i kultivuar, natyral, tapet bari, ujë, punim rrënjësh, plehërim, spërkatje me pesticide. Kryerja e kontrolleve të rregullta të mirëmbajtjes për dy makineri (2 prerëse bari)

V626AAG Trotuare të mirëmbajtur dhe rehabilituar. Sipërfaqe trotuaresh e mirëmbajtur në qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, zëvendësimi i pllakave dhe bordurave, rregullimin e sinjalistikës; rregullimin e stolave; etj.

V626AAH Objekte publike të mirëmbajtura. Mirëmbajtja rutinë dhe periodike e objekteve të ndryshme administrative në pronësi të bashkisë, si psh. lapidarë, shatërvane, etj

Ndriçim Rrugësh

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 8,480 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 1,416 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë në vlerën 59,929 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për investime në vlerën 800 mijë lekë.

Këto shpenzime lidhen me produktet si më poshtë:

V644AAA Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes së Ndricimit Publik. Këtu përfshihen pagesa e pagave dhe sigurimeve për stafin që merret me Ndricimin Publik

V644AAB Rrjeti i ndriçimit rrugor publik urban i mirëmbajtur. Këtu përfshihet pagesa për rrjetin aktual të ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat qytet të NJVQV;



BASHKIA KORÇË

000/lekë

PBA 2024-2026								
(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK								
Programi	AE122	Shërbimet Publike Vendore						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime		192,937.0	202,471.0	252,682.0	269,420.0	293,994.3	282,854.0	285,681.0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	165,327.0	173,485.0	216,666.0	230,798.0	252,009.3	242,382.0	244,803.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	27,610.0	28,986.0	36,016.0	38,622.0	41,985.0	40,472.0	40,878.0
Shpenzime Korente të Tjera		231,493.0	251,285.0	277,674.0	293,771.0	290,222.5	280,666.0	284,380.0
Mallra dhe Shërbime	602	220,673.0	232,931.0	267,674.0	283,022.0	280,222.5	270,666.0	274,380.0
Subvencion	603	9,999.0	9,999.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0
Transferta të Brendshme	604	313.0				0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605					0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	508.0	8,355.0		749.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166					0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651					0.0	0.0	0.0
Rezervat	609					0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale		19,431.0	3,521.0	83,655.0	116,392.0	109,696.9	139,718.0	179,469.0
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	19,431.0	3,521.0	83,655.0	116,392.0	109,696.9	139,718.0	179,469.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		443,861.0	457,277.0	614,011.0	679,583.0	693,913.7	703,238.0	749,530.0

Matrica e shpenzimeve operative me produkte dhe matrica e investimeve paraqiten sipas tabelës nr. 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

10.2.Klubi Shumësportësh

10.2.1.Programi: Kultura Sporti dhe Argëtim AF122

Në këtë program përfshihet funksionimi ose mbështetja e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive (fusha lojërash, fusha tenisi, korsi vrapimi, etj.); mbështetja për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive si dhe zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë



BASHKIA KORÇË

kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave, e të ambjenteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytetar. Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave. Organizimi ose mbështetja për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe shfaqje artistike etj). Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore.

Në këtë program përfshihet buxheti për Klubin Shumësportësh në vlerën 54,369 mijë lekë dhe Qendra e Artit dhe Kulturës në vlerën 102,916 mijë lekë, të paraqitura sipas tabelës së mëposhtme për vitet 2021-2026.

000/lekë

PBA 2024-2026								
(E1) SHPENZIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK								
Programi	AF122	Kultura, Sport dhe Argëtim						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
Emërtimi i Llogarisë	Kodi	Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime		33,893.0	35,923.0	43,218.0	44,632.0	50,854.5	48,392.0	48,876.0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	29,033.0	30,763.0	37,090.0	38,240.0	43,634.8	41,508.0	41,875.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	4,860.0	5,160.0	6,128.0	6,392.0	7,219.6	6,884.0	7,001.0
Shpenzime Korente të Tjera		68,403.0	77,822.0	86,886.0	95,058.0	102,690.4	89,500.0	89,500.0
Mallra dhe Shërbime	602	68,258.0	76,496.0	86,886.0	94,559.0	102,690.4	89,500.0	89,500.0
Subvencion	603					0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604					0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605					0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	145.0	1,326.0		499.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166					0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651					0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzime Kapitale		4,987.0	12,368.0	2,180.0	2,180.0	3,740.0	2,180.0	2,180.0
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	120.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	4,987.0	12,368.0	2,180.0	2,060.0	3,740.0	2,180.0	2,180.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali		107,283.0	126,113.0	132,284.0	141,870.0	157,284.8	140,072.0	140,556.0

Buxheti për vitin 2024 për Klubin Shumësportësh është në vlerën **54,369 mijë lekë**. Detajimi I buxhetit si më poshtë:

- shpenzime personeli 11,833 mijë lekë
- shpenzime korrente 42,296 mijë lekë
- Shpenzime për investime 240 mijë lekë



BASHKIA KORÇË

Shpenzimet për personelin (600+601) për vitin 2024, do të jenë në vlerën 11,833 mijë lekë mijë lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit 2023 ka një rritje prej 2,180 mijë lekë ose 22.5%, dhe krahasuar me planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një rritje prej 1,288 mijë lekë ose 12%. Kjo rritje vjen si rezultat i zbatimit të VKM nr 326 datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, kategoritë e pagave nga klasa I deri XIII pësuan ndryshime, VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV”, si dhe VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

Shpenzimet korrente (602) për vitin 2024 do të jetë në vlerën 42,295 mijë lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit 2023 ka një rritje prej 3,251 mijë lekë ose 8.3% dhe krahasuar me planin e ndryshuar të vitit 2023 ky fond ka një rritje prej 3,561 mijë lekë ose 9%.

Shpenzimet për investime (231) për vitin 2024 do të jenë në vlerën 240 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për paga është 10,159 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është 1,674 mijë lekë .

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë 42,295 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime do të jetë 240 mijë lekë

Produktet e përfshira në këtë program janë:

V813AAA Shërbimi i stafit të Sportit dhe Argëtimit. Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që merret me aktivitetet artistike dhe kulturore të njësive të vetëqeverisjes vendore.

V813AAB Disiplinat e ndryshme sportive të mbështetura. Këtu përfshihen shpenzimet e planifikuara nga njësiti e vetëqeverisjes vendore për të mbështetur sportisë, stafet mbështetëse të disiplinave sportive dhe trajtimin financiar të tyre. Sipas disiplinave do të kostohet shpenzimet referuar nevojave për paga, uniforma, dieta etj. Këtu do të përfshihen edhe shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e terreneve sportive në dispozicion të disiplinave të ndryshme sportive.

Matrica e shpenzimeve operative me produktet dhe matrica e investimeve paraqiten sipas tabelës nr. 2 dhe 3 bashkangjitur materialit.

10.3. Qendra e Artit dhe Kulturës

10.3.1. Programi: Kultura, Sporti dhe Argëtim AF122

Buxheti i këtij institucioni është në vlerën **102,916 mijë lekë** si më poshtë:

-	Shpenzime personeli	39,021 mijë lekë
-	Shpenzime korrente	60,395 mijë lekë
-	Shpenzime për investime	3,500 mijë lekë

Shpenzimet për personelin (600+601) për vitin 2024, do të jenë në vlerën 39,021 mijë lekë mijë lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit 2023 ka një rritje prej 5,456 mijë lekë ose 16% dhe krahasuar me



BASHKIA KORÇË

planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një rritje prej 4,935 mijë lekë ose 14%. Kjo rritje vjen si rezultat i zbatimit të VKM nr 326 datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, kategoritë e pagave nga klasa I deri XIII pësuan ndryshime, VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV”, si dhe VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

Shpenzimet korrente (602) për vitin 2024 do të jetë në vlerën 60,395 mijë lekë, krahasuar me planin fillestar të vitit 2023 ka një rritje prej 12,553 mijë lekë ose 26% dhe krahasuar me planin e ndryshuar të vitit 2023 ka një rritje prej 11,193 mijë lekësh ose në masën 22%.

Fondi i planifikuar për paga është 33,476 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është 5,545 mijë lekë

Këto shpenzime lidhen me produktet si më poshtë:

V822AAA Shërbimet e stafit të trashëgimisë Kulturore, muzeve, bibliotekave. Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që mbulon objektet e trashëgimisë kulturore, muzetë dhe bibliotekave të njësive të vetëqeverisjes vendore.

